



1 Qershori, fëmijët “pushtojnë” Bazën Ajrore Farkë

Me rastin e 1 Qershorit, fëmijët e moshave të ndryshme vizituan Bazën Ajrore, Farkë. Të vegjëlvë iu dha mundësia të shohin bazën ajrore, të prekin mjete e pajisje, të cilat përdoren në raste emergjencash dhe jo vetëm, të takojnë pilotët dhe të zhvillojnë edhe fluturime të shkurtra me helikopter. Ky aktivitet, përveçse është një

mënyrë për të kënaqur fëmijët në ditën e tyre të festës, është edhe një mundësi promovimi për Forcat e Armatosura, për të frymëzuar brezin e ardhshëm të orientohen drejt FA-së. Po ashtu, aktivitetet të tilla kanë si qëllim promovimin e aviacionit dhe të nxjerrin në pah profesionalizmin e personelit të FA-së.



» faqe 2

“Defender 23”, NATO dhe SHBA garantuese të rendit dhe sigurisë në zonën euroatlantike



» faqe 3

Përfundoi Kursi i 13-të i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi në mjediset e auditoriumit ceremoninë e certifikimit të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-13. Në këtë ceremoni morën pjesë, SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, atashë ushtarakë, prefekti i qytetit të Fierit, komandantë të njësive kryesore të FA-së, drejtore gjithashtu edhe ushtarakë të lartë të MM-së dhe SHPFA. Në fillim të tij të rastit zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë...



» Faqe 4

Vetëm në një trup të fortë dhe të shëndetshëm shpirti ruan ekuilibrin dhe karakteri zhvillohet me gjithë fuqinë e tij

Niveli i përgatitjes fizike të ushtarakëve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gatishmërinë e luftimit dhe plotësimin e misionit. Nëpërmjet arsimimit dhe stërvitjes, ushtarakët e Forcave të Armatosura janë të gatshëm për të kryer misionet që iu caktohen. Për shtypin ushtarak, dr. Valbona Ze-kaj, pedagoge e përgatitjes fizike, sjell disa prej arsyeve pse është e rëndësishme përgatitja fizike për një ushtarak dhe jo vetëm, disa prej arritjeve që kemi në këtë fushë dhe njëkohësisht problematikat që hasen...



» Faqe 6-7

Për një axhendë kërkimore mbi studimet dhe kërkimet e terrorizmit

Vëzhgimi mbi terrorizmin ka bërë një rrugë të gjatë. Në veçanti, 20 vitet e fundit kanë parë një ndryshim në kërkimin e kësaj fushe. Megjithatë, terrorizmi dhe kundër-terrorizmi kanë qenë gjithmonë tema sfiduese për t'u studiuar në institucionet publike dhe ato shkencore. Ai ka qenë i diskutueshëm, gjatë gjithë shekullit të njëzetë, studimi i të dyja fushave fshihej në kufijtë e kërkimit shkencor. Kishte pak studime për të kryer karrierën e tyre në këtë zonë, ajo ishte jashtëzakonisht e kufizuar brenda dhe jashtë kërkimeve shkencore dhe...



» Faqe 8



1 Qershori, fëmijët "pushtojnë" Bazën Ajrore Farkë

Me rastin e 1 Qershorit, fëmijët e moshave të ndryshme vizituan Bazën Ajrore, Farkë.

Të vegjëlle iu dha mundësia të shohin bazën ajrore, të prekin mjete e pajisje, të cilat përdoren në raste emergjencash dhe jo vetëm, të takojnë pilotët dhe të zhvillojnë edhe fluturime të shkurtra me helikopter.

Ky aktivitet, përveçse është një mënyrë për të kënaqur fëmijët në ditën e tyre të festës, është edhe një mundësi promovimi për Forcat e Armatosura, për të frymëzuar brezin e ardhshëm të orientohej drejt FA-së. Po ashtu, aktivitete të tilla kanë si qëllim promovimin e aviacionit dhe të nxjerrin në pah profesionalizmin e personelit të FA-së.



Zhvillohet stërvitja "GRUPEX-23"

Flotilja Detare, Pashaliman, zhvilloi në rajonin e Gjirit të Vlorës stërvitjen "GRUPEX-23" dhe qitjet bregdetare, me armatimin e grupit I dhe të II të anijeve patrulluese. Kjo stërvitje kishte si qëllim vlerësimin dhe certifikimin e grupeve të anijeve patrulluese si njësi zbatuese, testimin e aftësive organizative dhe komanduese të komandantëve të grupeve, planëzimin e Shtabit të Flotiljes Detare, si dhe kryerjen e qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve. Në këtë stërvitje u përpunuan 10 skenarë stërvitor, ndër më kryesorët ishin: operacionet e Ndalimit Detar (MIO), operacionet e kërkim - shpëtimit (SAR), mbrojtja e forcës në det (FIAC), lundrimi i përbashkët i njësive detare, operacionet e evakuimit jo - luftarak (NEO), si dhe realizimi i qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve. Qitjet u zhvilluan në distancë të ndryshme, sipas kalibrave që posedonte çdo anije. Stërvitja u drejtua nga komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, si dhe u vëzhgua nga afër nga Shtabi i Forcës Detare.





“Defender 23”, shembull i faktit se NATO dhe aleatët janë më të fortë së bashku, garantuese të rendit dhe sigurisë në zonën euroatlantike

Stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 23” mbylli aktivitetet e saj në territorin e Shqipërisë. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, në garnizonin e Zall Herrit, i pranishëm ishte dhe Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, i cili në vlerësimin e tij për suksesin e kësaj stërvitjeje, theksoi dhe arritjet e saj tek trupat ushtarake shqiptarë si, testimi i elementëve të dislokueshmërisë dhe ndërveprueshmërisë në përgjigje të krizave, në një diapazon të gjerë operacionesh, si dhe aftësitë e potencialet e vendeve pritëse.

Mes të tjerash ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi transmetoi edhe një mesazh shumë të fuqishëm, atë të unitetit.

“Stërvitje të tilla demonstrojnë qartazi angazhimin e SHBA-ve dhe NATO-s si garantuese të rendit dhe sigurisë në zonën euroatlantike. ‘Defender’ përbën një shembull të qartë dhe konkret të faktit se NATO dhe aleatët janë më të fortë së bashku, duke kontribuar dhe investuar në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse kolektive”, - theksoi Ministri Peleshi.

Z. Peleshi tha se Shqipëria dëshmoi një eksperiencë të shkëlqyer në drejtim të pritjes dhe zhvillimit të stërvitjeve ushtarake në të tilla përmasa, duke rikonfirmuar aftësitë e Forcave të Armatosura për të qenë të ndërveprueshme me ushtritë simotra të Aleancës.

“Si Ministër i Mbrojtjes, shpreh mbështetjen e gjithanshme të Qeverisë si dhe angazhimin tim personal se do të



punojmë pa reshtur për modernizimin e Forcave të Armatosura, me qëllim që ato të jenë të pajisura, të trajnuara dhe të mbështetura në çdo kohë, për të bërë të mundur përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve në kuadër të NATO-s”, - deklaroi ministri Peleshi.

Për më se një muaj, mbi 24 mijë trupa ushtarake nga 26 vende të NATO-s dhe partnerë të saj demonstruan fuqinë në shumë vende njëherësh, nëpërmjet

skenarëve strategjikë dhe realizimin e detyrave operacionale në tokë, ajër e det. Në përfundim të aktivitetit u shpërndanë “Certifikata Mirënjohje” për 17 ushtarake të huaj, pjesëmarrës në stërvitjet që u zhvilluan në vendin tonë në kuadër të “Defender 23”, në shenjë vlerësimi dhe falënderimi nga Ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi në mjediset e auditoriumit ceremoninë e certifikimit të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-13.

Në këtë ceremoni morën pjesë, SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, atashe ushtarakë, prefekti i qytetit të Fierit, komandantë të njësive kryesore të FA-së, drejtorë gjithashtu edhe ushtarakë të lartë të MM-së dhe SHPFA.

Në fjalën e tij të rastit zëvendës-komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi falënderoi kursantët e KLSM-13 për pjesëmarrjen e tyre, angazhimin dhe vlerat e treguara. Ky kurs ka një rendësi të veçantë pasi kurrikula e tij është e pasur me temat e fundit të mjedisit, sigurisë dhe mbrojtjes. Ai citoi se një falënderim shkon për vendet që dërguan përfaqësuesit e tyre në këtë kurs si, Bullgarinë, Gjeorgjinë, Italinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën. Ai falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm për mbështetjen e dhënë në realizimin me sukses të këtij kursi. Më pas, në emër të kursit përshëndeti kolonel Nikolaos Lekkas, i cili tha: “Dëshiroj të falënderoj fillimisht institucionin e kursit dhe nëpërmjet tij edhe Shtetin shqiptar për mikpritjen, mbështetjen dhe qasjen miqësore ndaj të gjithë pjesëmarrësve të kursit tonë. Përzgjedhja e kujdesshme e temave të diskutuara, ftesa e shumë folësve të nderuar të ftuar dhe ekspertëve të çështjeve civile dhe ushtarake nga institucione të ndryshme nga Shqipëria, SHBA-të dhe Evropa, si dhe udhëtimet studimore në terren, e bënë këtë kurs shumë interesant, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe arritjen e objektivave të trajnimit. Më lejoni t’iu drejtoj disa fjalë pjesëmarrësve të këtij kursi, në të vërtetë miqtë dhe partnerët e mi të rinj. Sinteza e klasës, një përzierje e ekuilibruar e Forcave të Armatosura Shqiptare dhe zyrtarëve të lartë të institucioneve të sigurisë së vendit, si dhe oficerëve të lartë nga eFP e NATO-s dhe vendeve të rajonit, krijoi një mjedis akademik sfidues, por edhe unik. Kolori i formimeve, aftësive dhe i përvojave të ndryshme akademike dhe profesionale sfiduan aftësitë tona të komunikimit dhe punës në grup, por dhe nxitën mirëkuptimin e përbashkët. Kuptuam se ndajmë interesa dhe shqetësime të përbashkëta për sigurinë, rajonin dhe jetën tonë.

Në përshëndetjen e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, pasi falënderoi pjesëmarrësit e kursit për përfundimin me sukses të Kursit të 13-të të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, vlerësoi kontributin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për përgatitjen dhe zhvillimin e këtij kursi prestigjioz për çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Në kurs morën pjesë 14 kursantë me përfaqësues nga MM, SHPFA dhe FA-të e Bullgarisë, Gjeorgjisë, Italisë, Greqisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës si dhe nga institucionet e larta të sigurisë në vendin tonë.



Përfundoi Kursi i 13-të i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen



Vizitorët e ishullit të Sazanit do të jenë të sigurt falë punës së palodhur të 12 specialistëve xhenierë të kompanisë xheniere të Batalionit të Mbështetjes me Luftim, të cilët kryen kontrollin vizual dhe pastrimin nga municionet e pa plasura.



Zhvillohen gara sportive me rastin e 65-vjetorit të krijimit të AFA-së

Me rastin e 65-vjetorit të krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), studentët e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) zhvilluan ndërmjet tyre, finalen e aktiviteteve sportive në disiplinën futboll, voleyboll e basketboll, për femra e meshkuj.

Të gjitha grupet mësimore të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) u angazhuan maksimalisht dhe me vrullin e pasionin e moshës i dhanë gjallëri ambienteve sportive të AFA-së, me brohoritjet e gjalla dhe tifozerinë spontane.

Në përfundim të garave, fitues sipas disiplinave u shpallën, në voleyboll, kompania "Enkelejdët", me lojtarin më të mirë student Orgest Duka; në basketboll, kompania "Dardanët" me lojtarin më të mirë student Endi Sherifi dhe në futboll, kompania "Ardianët" me lojtarin më të mirë student Mikel-jano Thimjo, të cilët me rezultatet e



tyre frymëzojnë të rinjtë që dëshirojnë të bëhen pjesë e FARSH.

Sportet, si një pikë e fortë e përgatitjes së oficerëve të rinj, janë mënyra më e mirë, jo vetëm për të mbajtur

kondicionin fizik, por edhe për rritjen e disiplinës, punës në grup, shpirtin e garës dhe korrektësinë, virtyte të cilat kultivohen në përgatitjen e brezave të rinj të ushtarakëve në AFA.



Kompania e MADM-së përfundoi stërvitjen e përbashkët me Gardën Kombëtare të New Jersey-t dhe një togë MADM e Forcave të Sigurisë së Kosovës. Gjatë këtij trajnimit, efektivët e të tre shteteve praktikuan teknikat e ndryshme të zbulimi kimik, radiacionit dhe u njohën me mjetin special për marrjen e mostrave biologjike. Trupat në trajnim u vizituan dhe nga Komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou.



Pas 8 javësh programi arsimor në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, u certifikuan 10 kursantë të Kursit Bazë të Nënoficerit në specialitetin "Këmbësori".



INTERVISTË ME DR. VALBONA ZEKAJ, PEDAGOGJE E PËRGATITJES FIZIKE, FMS

Vetëm në një trup të fortë dhe të shëndetshëm shpirti ruan ekuilibrin dhe karakteri zhvillohet me gjithë fuqinë e tij

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Niveli i përgatitjes fizike të ushtarakëve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gatishmërinë e luftimit dhe plotësimin e misionit. Nëpërmjet arsimimit dhe stërvitjes, ushtarakët e Forcave të Armatosura janë të gatshëm për të kryer misionet që iu caktohen. Për shtypin ushtarak, dr. Valbona Zekaj, pedagoge e përgatitjes fizike, sjell disa prej arsyeve pse është e rëndësishme përgatitja fizike për një ushtarak dhe jo vetëm, disa prej arritjeve që kemi në këtë fushë dhe njëkohësisht problematikat që hasen në mbarëvajtjen e ushtrimit me efikasitet të disiplinave të ndryshme.

Dr. Valbona Zekaj në rrugëtimin e saj profesional

Prej vitit 1999 deri në vitin 2002, basketbolliste e Ekipit Kombëtar, më pas basketbolliste profesioniste me ekipin e parë të Klubit “Studenti”, Tiranë.

Në vitin 2004-2014, pedagoge në degën e Edukimit Fizik, Universiteti Ushtarak “Skënderbej”. Prej vitit 2014 e në vazhdim, shefe Seksioni, pedagoge pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Valbona Zekaj mban titullin “Doktor Shkencash”; Diplomë e nivelit të Trete PHD për Sigurinë dhe Mbrojtjen Ndërajonale, si dhe Diplomë të Nivelit të Dytë DND, Master Shkencor në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporteve, Universiteti i Sporteve “Vojo Kushi”, Tiranë.

Cilat janë programet e përgatitjes fizike që ofron AFA?

Programet e përgatitjes fizike të Akademisë së Forcave të Armatosura varen nga programi që ka Akademia, pra aktualisht kemi një program tre-vjeçar dhe kemi hyrë në programin katërvjeçar të AFA-së, siç është ‘West Point’. Në këtë program përgatitja fizike është pjesë e programit të AFA-së gjatë katër viteve, ku çdo vit ka 60 orë, të cilat përkthehen në notë, pra një të tretën e programit mësimor e zë përgatitja fizike.

Cilat janë disiplinat sportive që i ofrohen studentëve të Forcave të Armatosura?

Disiplinat janë të ndryshme, duke filluar nga atletika, gjimnastika, brezi i kalitjes, noti, fushimi veror, fushimi dimëror, alpinizmi e të tjera lojëra sportive. Disiplinat kryesore janë atletika dhe brezi i kalitjes, në atletikë sfidë është 8000 metërshi dhe brezi i kalitjes, në forcë është përsëri sfidë gjimnastika dhe brezi i kalitjes. Pjesë e aktiviteteve janë edhe lojërat, të cilat janë për pjesëmarrjet e kadetit në aktivitetet e ndryshme sportive.

Si ndikon përgatitja fizike në psikologjinë e njeriut, dhe për më tepër të një ushtaraku?

Përgatitja fizike në AFA, për

eksperiencën time 20-vjeçare është baza, ndikon shumë në psikologjinë e kadetëve, e bën më të fortë, më të shkathët, forcon karakterin, e bën një lidership, sepse duke qenë mirë në përgatitjen fizike, nesër mund të jetë një lidership shumë i mirë në Forcat e Armatosura. Janë studime të ndryshme, që kam bërë dhe vetë personalisht, që tregojnë se përgatitja fizike është baza për një lidership ushtarak.

Sa i rëndësishëm është kondicioni fizik për një ushtarak?

Është shumë i rëndësishëm. Një ushtarak, i cili nuk është mirë në kondicionin fizik, nuk arrin të marrë dot as gradën ushtarake. Pra çdo gradë ushtarake ka një testim fizik, siç është



DISIPLINAT SPORTIVE QË I OFROHEN STUDENTËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA JANË TË NDRYSHME, DUKE FILLUAR NGA ATLETIKA, GJIMNASTIKA, BREZI I KALITJES, NOTI, FUSHIMI VEROR, FUSHIMI DIMËROR, ALPINIZMI E TË TJERA LOJËRA SPORTIVE. DISIPLINAT KRYESORE JANË ATLETIKA DHE BREZI I KALITJES, NË ATLETIKË SFIDË ËSHTË 8000 METËRSHI DHE BREZI I KALITJES, NË FORCË ËSHTË PËRSËRI SFIDË GJIMNASTIKA DHE BREZI I KALITJES.





3200-shi, 2 min. muskulaturë barku, 2 min. pompa, dhe nëse ushtaraku nuk arrin të kalojë këtë testim fizik, në bazë të programit dhe në bazë të testit që është vendosur nga forcat e armatosura, nga një grup pune, i ngritur prej kohësh tashmë, ushtaraku nuk merr gradën përkatëse, duke filluar që nga grada e kapitenit e deri te grada më e lartë, gjeneral. Pra konsiderohet element kryesor për një ushtarak, sepse nesër një ushtarak i mirë do t'i duhet të marrë pjesë në misione të ndryshme ndërkombëtare dhe kondicioni fizik është baza dhe në bazë të politikave të Ministrisë dhe shefit të Shtabit, kondicioni fizik luan një rol të rëndësishëm.

Cilat janë disa nga objektivat tuaja, për arritjen e një niveli sa më të lartë të ushtarakëve tanë?

Objektivat tona, jo vetëm të miat, por të të gjithë stafit të përgatitjes fizike, sepse janë edhe katër pedagogë të shkëlqyer, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre dhe objektivat e nivelit janë rritur tashmë. Pra, duke qenë se kërkohet nga lart që përgatitja fizike të jetë vendimmarrëse kryesore në lider-shipin ushtarak si rrjedhojë dhe niveli e kërkesa janë rritet, duke rritur standartet e arritjes dhe punën e detyrueshme të një ushtaraku, i cili duhet të punojë të paktën dy orë ë ditë për të arritur këto standarde. Është e domosdoshme, e kërkon vetë NATO-ja. Të jesh ushtarak

ka shumë lidhje me përgatitjen fizike, për mua janë të dyja një nivel. Pra një gjeneral, një kolonel apo major, të gjitha gradat ushtarake duhet të kenë të njëjtin nivel të përgatitjes fizike.

Cila është filozofia juaj mbi mënyrën e trajtimit, për kushte fizike sa më të mira tek të rinjtë dhe të rejtat e Forcave të Armatosura?

Këtu ka të bëjë shumë mënyra e trajnimit të ushtarakëve që janë emëruar për përgatitjen fizike nëpër reparte, të cilët për mua duhet të jenë të detyrueshëm. Siç e thashë edhe më lart, një ushtarak i mirë duhet të kalojë normat e përgatitjes fizike, të testohet dhe pastaj të futet në testin psikologjik dhe

në testet e tjera për të marrë një gradë shkencore, duhet të jetë kryesorja. Besoj që me politikat e shefit të Shtabit dhe Ministrisë, pa diskutim, këto politika po ngrihen sepse tashmë janë vënë si detyrë testimi fizik, psikologjik etj. Pra janë politika të vendosura nga shefi i Shtabit, por në aspektin që trajtojmë ne si staf pedagogjik, studenti, i cili nuk arrin të kapë normat, konsiderohet mbetës, dhe në momentin që është mbetës e nëse ai nuk arrin të kalojë as në vjeshtë, automatikisht humb vitin shkollor, pra ka shumë vlerë përgatitja fizike.

Çfarë rëndësie ka trekëndëshi 'Forcë, Moral, Motivim'?

Unë mund të flas për motivin. Një



PËRGATITJA FIZIKE NË AFA, PËR EKSPERIENCËN TIME 20-VJEÇARE ËSHTË BAZA, NDIKON SHUMË NË PSIKOLOGJINË E KADETËVE, E BËN MË TË FORTË, MË TË SHKATHËT, FORCON KARAKTERIN, E BËN NJË LIDERSHIP, SEPSE DUKE QENË MIRË NË PËRGATITJEN FIZIKE, NESËR MUND TË JETË NJË LIDERSHIP SHUMË I MIRË NË FORCAT E ARMATOSURA. JANË STUDIME TË NDRYSHME, QË KAM BËRË DHE VETË PERSONALISHT, QË TREGOJNË SE PËRGATITJA FIZIKE ËSHTË BAZA PËR NJË LIDERSHIP USHTARAK.

këtë aktivitet, ku ne dolëm në vend të dytë dhe motivimi ynë si pedagogë është te nota. Pra japim automatikisht një notë plus në përgatitjen fizike, sepse të marrësh notën 10 në përgatitjen fizike është shumë e vështirë; do të kalojnë brezin e kalitjes, 8000-shin, gjimnastikën, atletikën 100 metër, pompa 2 minuta, muskulaturën e barkut 2 minuta, të gjitha këto me kohë, të cilat janë të shkruara në tabelën kryesore të Akademisë së Forcave të Armatosura. Këto të dhëna i gjen kudo, dhe janë me grupmosha. Ky është motivimi që mund t'i japim një studenti. Kemi studentë që shkëlqejnë në 5-garëshin ushtarak, kemi studentë që kanë shkëlqyer jashtë në aktivitete të NATO-s, për shembull studentët tanë kanë shkëlqyer në atletikë, në gara të 5-garëshit jashtë vendit, dhe ky është një motivim që ne i japim, është investim i pedagogëve tanë, duke qenë se ata stërviten nga ne.

Cilët janë elementët që duhen përdoruar për një shëndet dhe përgatitje fizike sa më të mirë?

Elementët janë një ushqyerje e mirë, stërvitje e mirë e sistematike, të kenë pasion sportin, që është edhe baza, duke uruar që të afrohen me shumë sportistë, si kadetë, sepse do të vazhdojnë qëndrimin këtu. Por më e rëndësishmja është ta kenë pasion sportin dhe stërvitjen, sepse kjo është edhe gjenetike, nuk mund të bëhet vetëm me detyrim, sepse është një element që duhet punuar edhe në vazhdimësi.

Cilat janë politikat e stërvitjes fizike të Forcave të Armatosura për trajnimin sa më të mirë të trupave tona ushtarake?

Politikat janë testimet, sepse nëpërmjet testeve detyrohen kadetët të arrijnë normat, ata testohen nga një grup pune i ngritur nga shefi i Shtabit, ku marrim pjesë edhe ne si pedagogë të përgatitjes fizike, pra një përfaqësues nga ne dhe një përfaqësues nga Shtabi. Pra janë politikat e Shtabit të Përgjithshëm, ku ngrihet komisioni për të testuar të gjithë ushtarakët kandidatë për marrjen e gradës, është një praktikë e cila bëhet dy herë në vit.

A është në parametrat e duhura infrastruktura fizike dhe ajo logjistike?

Është normale që ka nevojë për përmirësime. Aktualisht kemi një projekt, Akademia e Forcave të Armatosura do të ketë së shpejti një korpus të ri, për të cilin na është marrë edhe mendimi ynë si specialistë të përgatitjes fizike, për fushat, për ambientet sportive, për palestrat etj., dhe jam shumë e kënaqur që po bashkëpunojmë.

Çfarë duhet? Duke filluar që nga pishina, për të cilën na është thënë që do të jetë në të dyja dimensionet, në pishinë të hapur dhe dimërore. Dhe kjo si një risi dhe shumë e domosdoshme për punën tonë. Kjo është një arritje dhe diçka pozitive për ne, që do na japë mundësinë për të qenë në nivele të përgatitjes fizike si ajo e 'West Point-it'.

Jam shumë e lumtur që ushtroj profesionin tim mes njerëzve në uniformë, mes të rinjve dhe të rejave, ushtarakëve të ardhshëm, të cilët na kanë dhënë shpesh trofe fitoreje në aktivitete sportive të ndryshme, ku vetëm pak ditë më parë ne zëmë vendin e dytë në 'futsal' mes 10 universiteteve të Tiranës.





N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Vëzhgimi mbi terrorizmin ka bërë një rrugë të gjatë. Në veçanti, 20 vitet e fundit kanë parë një ndryshim në kërkimin e kësaj fushe. Megjithatë, terrorizmi dhe kundër-terrorizmi kanë qenë gjithmonë tema sfiduese për t'studiuar në institucionet publike dhe ato shkencore. Ai ka qenë i diskutueshëm, gjatë gjithë shekullit të njëzetë, studimi i të dyja fushave fshihej në kufijtë e kërkimit shkencor. Kishte pak studiuës për të kryer karrierën e tyre në këtë zonë, ajo ishte jashtëzakonisht e kufizuar brenda dhe jashtë kërkimeve shkencore dhe akademike, ku kishte mendime nëse terrorizmi dhe kundër-terrorizmi ishin tema të përshtatshme për studime shkencore, të cilat vunë në pikëpyetje gjithashtu motivet e çdo studiuesi që dëshironte për të eksploruar çështje të tilla. Sulmet e 11 shtatorit paralajmëruan një rritje të madhe të interesit politik, publik dhe akademik për terrorizmin dhe kundër-terrorizmin; Lufta globale kundër terrorit dhe trashëgimitë e saj dominuan politikën ndërkombëtare në dy dekadat e para të shekullit të njëzet e një. Asnjëherë më parë në histori nuk ka tërhequr kaq shumë vëmendje e polemika terrorizmi dhe mënyra se si duhet luftuar ai. Vetë studimi i terrorizmit është katapultuar nga errësira akademike në një lëndë që mësohet në mënyrë rutinore në shumicën e universiteteve.

Studimet e terrorizmit prodhojnë tani një nivel të paprecedentë kërkimi dhe shkrimi, megjithëse cilësia e një pjese të madhe të kësaj lënde është shumë për të dëshiruar, shpesh duke vuajtur nga metodat e dobëta të kërkimit, konfuzioni konceptual dhe paragjykimi politik. Megjithatë, ndonëse sigurisht që ka probleme, në përgjithësi, kërkimi mbi terrorizmin është ende i gjallë, dhe mes një tufe studimesh në shumë fusha, ka një rritje kërkimesh me cilësi të lartë që ofrojnë gjetje të përparimit dhe njohurive të vërteta. Në përgjithësi, ka të ngjarë që studiuesit e ardhshëm ta shohin këtë periudhë si një fazë të rëndësishme dhe transformuese në kuptimin tonë të terrorizmit dhe kundër terrorizmit, ndoshta edhe si një epokë tjetër. Duke u nisur nga ky kontekst, nevoja për një pasqyrë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse mbi shumë nga çështjet dhe sfidat e diskutueshme me të cilat përballen studimet bashkëkohore të terrorizmit mbetet e thellë. Ky është pra motivimi që qëndron pas këtij vëllimi aktual: për të ofruar një pasqyrë të gjerë të gjendjes aktuale të analizave dhe kërkimeve

Për një axhendë kërkimore mbi studimet dhe kërkimet e terrorizmit



akademike mbi terrorizmin dhe kundër-terrorizmin, si dhe një vlerësim të informuar të drejtimeve të ardhshme të studimeve me objekt terrorizmin. Sot, ka shumë shkrime dhe libra mbi kërkimin e terrorizmit, të cilët hapen me një eksplorim të pyetjes së përkufizimit afatgjatë. Problemi i përkufizimit ka pllakosur studimet e terrorizmit që në fillim, dhe një përkufizim i pranuar universal i asaj që përbën terrorizëm i ka rezistuar me kokëfortësi përpjekjeve për t'u fiksuar. Arsyet e dështimit njihen mirë, por kjo nuk i ka ndalur disa përpjekje për të formatuar një përkufizim universal, si një përpjekje e spikatur për të identifikuar një përkufizim konsensusi, të cilat janë afruar te rezultatet përfundimtare, por ende nuk kanë arritur statusin e konsensusit. Ndoshta për një shkrim të fokusuar në përcaktimin e një axhende kërkimore për studimet për terrorizmin, ne nuk mund të quajmë të argumentuar formimin për një përkufizim të veçantë.

Në të kundërt mund të themi se është shpenzuar shumë kohë në një kërkim jo të plotë, në tërësi janë më të prirur të rekomandojnë braktisjen e kërkimit për një përkufizim konsensusi, pra ka pak kërkues për të bindur lexuesit për ndonjë interpretim të veçantë të preferuar.

Theksojmë se paqartësia e përkufizimit është një veçori e shumë fushave të studimit dhe nuk është unike për studimet e terrorizmit. Mjegullimi rreth skajeve konceptuale mendoj se nuk pengon përparimin shkencor si në

çdo fushë tjetër edhe në atë të sigurisë ndaj terrorizmit.

Përkundrazi, mund të jetë tregues i pasurisë disiplinore, teorike dhe metodologjike. Kjo nuk do të thotë se nuk nevojitet asnjë përkufizim, por që studiuesit thjesht janë të qartë se çfarë përkufizimi kanë përdorur në një studim të caktuar. Ne po kuptojmë se të tjerët mund të gjykojnë nëse ky fokus do të thotë se gjetjet janë të rëndësishme (ose jo) për sa i përket kornizave që ata përdorin më për punën e mëvonshme. Sot, vlen që jo vetëm të përmenden por edhe t'i kushtohet kujdes përcaktimit të konceptit të përkufizimit por qasjeve, të cilat sjellin tronditjet shoqërore. Merrni, për shembull, vëzhgimin mbi shkaqet e terrorizmit. Studime të ndryshme që shikojnë shkaqet ndryshojnë për sa i përket mënyrës se si e përkufizojnë terrorizmin. Kjo do të thotë, për shembull, që rastet e studimit që konsiderohen të ligjshme për t'u përfshirë në një studim nuk konsiderohen relevante në një tjetër. Një studim mund të ketë një fokus shumë të ngushtë, duke eksploruar vetëm raste të terrorizmit të kryer nga aktorë të vetëm, siç është rasti i goditjes së vendit tonë në fushën e shërbimeve publike; një tjetër mund të fokusohet në vend të kësaj në konflikte të cilat potencialisht mund të konsiderohen gjithashtu si kryengritje ose luftëra civile; ndërsa një studim i tretë mund të jetë shqyrtimi i përdorimit të terrorizmit në nivel shtetëror. Të tre studimet në teori mund të shikojnë shkaqet e terrorizmit, por

a jo që secili do të thotë me terrorizëm, është shumë e ndryshme. Në mënyrë të pashmangshme, studimet vijnë në përfundime të ndryshme. Probleme të ngjashme vlejnë për sa i përket kërkimit mbi kundër-terrorizmin: saktësisht çfarë lloj terrorizmi po kundërshtohet? Kjo nuk shprehet gjithmonë qartë me rezultatin e parashikueshëm që mund të ketë konfuzion dhe gjetje të përziera rreth asaj që funksionon dhe çfarë jo. Faktorët që identifikohen si kritikë të rëndësishëm në një rast mungojnë plotësisht ose nuk kanë efekt në një rast tjetër. Kështu, ne duhet të jemi vigilentë se si të vëzhgojmë dhe të vlerësojmë eksperiencën nga e kaluara, që në një farë mase kanë përcaktuar terrorizmin, cilat akte dhe aktorë janë përfshirë dhe çfarë është lënë jashtë.

Edhe pse qartësia konceptuale është sigurisht e nevojshme në një nivel më të lartë, në lidhje me mënyrën se si përkufizohet terrorizmi, që ajo të zbatohet në kontekste më të aplikuara. Për shembull, mënyra se si kërkimet janë përfshirë me fenomenin e terrorizmit të një aktori të vetëm, na jep një rast të shkëlqyer për t'u marrë në konsideratë. Pjesa më e madhe e kërkimit mbi aktorët e vetmuar është fokusuar në ndërtimin e grupeve të të dhënave të sulmeve të personave të vetëm dhe/ose karakteristikave të autorëve. Këto grupe të dhënash zakonisht bazohen në informacionin e mbledhur nga burime të hapura, duke përfshirë raportet gjyqësore, artikujt shkencorë, llogaritë autobiografike dhe

raportet e lajmeve të medias.

Megjithatë, ka pasur ndryshime të konsiderueshme midis grupeve të të dhënave për sa i përket kritereve të përdorura për të përcaktuar se kush konsiderohet si një aktor i vetëm terrorist. Disa kërkues dhe analistë, të cilët kanë vënë re se një terrorist ujk i vetmuar nuk komploton me askënd në përpjekjen e tyre për të kryer dhunë politike. Nuk ka asnjë palë të dytë, asnjë palë të tretë ose më shumë. Ujku i vetmuar vepron krejtësisht i vetëm". Eksperiencat në lidhje me mënyrën se si studime të ndryshme kanë ekzaminuar terrorizmin e një aktori të vetëm na japin mundësinë e një ilustrimi të dobishëm se si përkufizimet mund të ndikojnë ndjeshëm në gjetjet e kërkimit, të japin llogari për disa dallime të rëndësishme midis gjetjeve të studimeve dhe të ndikojnë në veprimet e mundshme më të gjera të kërkimit.

Në fund të fundit, në nuk po bëjmë thirrje që vetëm një përkufizim të përdoret në të gjitha studimet. Nëse kemi të bëjmë me terma të nivelit të lartë si terrorizmi, ekstremizmi, radikalizmi ose kontekste më të aplikuara, si p.sh. me aktorë të vetëm siç u diskutua më lart, të presim ose të kërkojmë përkufizime ose kritere të pranueshme botërisht është joreale. Përkundrazi, prioriteti është që të kemi qartësi në përkufizimet dhe kriteret specifike të përdorura në studime individuale. Në vend të saj, do të mjaftojë qartësia se çfarë nënkuptohet brenda kontekstit të secilit studim specifik.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S DREJTON TAKIMIN NË OSLO

Nuk i takon Moskës të ketë veto kundër zgjerimit të NATO-s

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Një takim jozyrtar i Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC) në nivel të ministrave të Punëve të Jashtme u mbajt në Oslo, Norvegji, më 31 maj-01 qershor 2023. Takimi u drejtua nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Duke mbërritur në Bashkinë e Oslos për të kryesuar takimin më 1 qershor 2023, Stoltenberg vuri në dukje se të gjithë aleatët pajtohen që Ukraina do të bëhet anëtare e Aleancës dhe se “nuk i takon Moskës të ketë veto kundër zgjerimit të NATO-s”. Ai shtoi se “më e rëndësishmja, të gjithë aleatët pajtohen se detyra më urgjente dhe më e rëndësishme tani është të sigurohet që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur”. Ai tha më tej se: “Ne duhet të sigurojmë që historia të mos përsëritet, që ky model i agresionit rus kundër Ukrainës të ndalet me të vërtetë. Prandaj, ne duhet të kemi korniza të vendosura për të ofruar garanci për sigurinë e Ukrainës pas përfundimit të luftës”.

Por Sekretari i Përgjithshëm u takua me kryeministrin norvegjez Jonas Gahr Støre në Oslo, më 30 maj 2023, përpara takimit jozyrtar të ministrave të Jashtëm aleatë. Ai falënderoi kryeministrin Gahr Støre për kontributin e konsiderueshëm të Norvegjisë në Aleancë dhe ndihmën e saj të rëndësishme për Ukrainën. “Unë e mirëpres që ju jeni angazhuar për një program ndihme pesëvjeçarë, kjo është diçka që me të vërtetë bën ndryshim, me mbështetje ushtarake, si dhe ndihmë financiare dhe humanitare”, - tha Stoltenberg. Ai më tej përhëndeti “rolin kyç të Kryeministrit në drejtimin e punës së NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës sonë kritike nënujore” dhe përgëzoi angazhimin e Norvegjisë për të arritur objektivin e shpenzimeve të mbrojtjes prej 2 për qind deri në vitin 2026.

Lidhur me dhunën e fundit kundër trupave të KFOR-it në veri të Kosovës, Stoltenberg tha se: “sulme të tilla janë të papranueshme dhe duhet të ndalen. KFOR-i, forcat e NATO-s, do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt për të gjithë qytetarët në Kosovë dhe do të vazhdojnë të veprojnë në mënyrë të paanshme, në përputhje me mandatin tonë të Kombeve të Bashkuara. Ne kemi vendosur të dislokojmë 700 trupa të tjera nga forca rezervë operative për Ballkanin Perëndimor dhe të vendosim një batalion shtesë të forcave rezervë në gatishmëri më të lartë, në mënyrë që ata të mund të dislokohen nëse është e nevojshme. Këto janë hapa të kujdesshëm për të siguruar që KFOR-i të ketë forcat dhe aftësitë që i nevojiten për të përmbushur mandatin e tij”. Sekretari i Përgjithshëm tha se: “Dhuna e spraps Kosovën dhe gjithë rajonin dhe i vë në rrezik aspiratat euroatlantike. Si Prishtina ashtu edhe Beogradi duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të depërshkallëzuar situatën, të përmbahen nga sjelljet e mëtejshme të papërgjegjshme dhe të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, i cili është e vetmja rrugë drejt paqes së qëndrueshme.

Norvegjia, rol thelbësor si një furnizues kryesor i energjisë për Evropën

“Norvegjia jep kontribute të vlefshme për sigurinë tonë të përbashkët. Forcat norvegjeze shërbejnë në grupin tonë të betejës shumëkombëshe në Lituani. Ju kontribuoni në misionet tona të policisë ajrore dhe ju luani një rol kyç në Veriun e Lartë. Ju organizoni stërvitje të rëndësishme siç u demonstrua me vizitën e USS Gerald Ford së fundmi”, - tha në konferencën e përbashkët për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg që mbajti me Kryeministrin e Norvegjisë, Jonas Gahr Støre.

Ai informoi se në takim trajtuan luftën e paligjshme të Rusisë kundër Ukrainës. “Norvegjia ofron ndihmë të konsiderueshme. Unë e mirëpres që jeni angazhuar për një program ndihme pesëvjeçarë. Kjo është diçka që bën vërtet ndryshim. Me mbështetje ushtarake, si dhe ndihma financiare dhe humanitare, kjo është diçka që ne të gjithë e vlerësojmë shumë. Unë kam besim se me mbështetjen e aleatëve të NATO-s, Ukraina mund të vazhdojë të çlirojë tokat e pushtuara dhe të mbizotërojë si një komb sovran, i pavarur”. Stoltenberg tha se në Samitin e NATO-s në Vilnius, Aleanca do të demonstrojë angazhimin e saj afatgjatë ndaj Ukrainës. “Lufta e ka bërë të qartë rolin thelbësor të Norvegjisë si një furnizues kryesor i energjisë për Evropën, duke luajtur një rol kyç në drejtimin e punës së NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës kritike nënujore, përfshirë tubacionet e energjisë. Duke u ndalur tek shpenzimet e Mbrojtjes ai tha kishin diskutuar nevojën për të investuar më shumë në mbrojtje. “Unë mirëpres angazhimin e Norvegjisë për të arritur objektivin prej 2% deri në vitin 2026. Unë pres që kur të takohemi në Vilnius, të biem dakord për një premtime të ri për investime në mbrojtje, ku tashmë 2% e PBB-së për mbrojtjen do të jetë një dysheme dhe jo më një tavan. Ne duhet të pranojmë se 2% është një minimum për të përmbushur detyrimet si aleat i NATO-s”, - tha ai.



Dhuna në Kosovë i rrezikon aspiratat euro-atlantike.

Do të veprohet në përputhje me mandatin e OKB-së

Duke iu drejtuar situatës në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm, tha se NATO dënon fuqishëm sulmet e paprovokuara kundër trupave të KFOR-it në veri të Kosovës, të cilat çuan në plagosjen e 30 paqeruajtësve. “Sulme të tilla janë të papranueshme dhe duhet të ndalen. KFOR-i, forcat e NATO-s, do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt për të gjithë qytetarët në Kosovë. Dhe ne do të vazhdojmë të veprojmë në mënyrë të paanshme, në përputhje me mandatin tonë të Kombeve të Bashkuara.

Ne kemi vendosur të dislokojmë 700 trupa të tjera nga forca rezervë operative për Ballkanin Perëndimor. Dhe për të vënë një batalion shtesë të forcave rezervë në gatishmëri më të lartë, në mënyrë që ato të mund të dislokohen nëse është e nevojshme. Këta janë hapa të kujdesshëm për të siguruar që KFOR-i ka forcat dhe aftësitë që i nevojiten për të përmbushur mandatin e tij.

Dhuna e zmbrajs Kosovën dhe gjithë rajonin dhe i vë në rrezik aspiratat euroatlantike. Si Prishtina ashtu edhe Beogradi duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të depërshkallëzuar situatën. Përmbahuni nga sjelljet e mëtejshme të papërgjegjshme. Dhe angazhohuni në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, i cili është e vetmja rrugë drejt paqes së qëndrueshme”, - tha Stoltenberg.

Pranimi i Suedisë në NATO mund të bëhet në Vilnius

Diskutime në takim pati gjithashtu për pranimin e Suedisë në Aleancë. “Suedia do të bëhet anëtare!”, - tha shefi i NATO-s, duke theksuar se “të gjithë aleatët e kanë ftuar atë të na bashkohet”. Ai tha se është në kontakt të ngushtë dhe të vazhdueshëm me autoritetet turke, për të siguruar që Suedia të bëhet anëtare e plotë sa më shpejt të jetë e mundur, dhe se ka folur disa herë me Presidentin Erdogan për pranimin e Suedisë në NATO. “Kjo është e rëndësishme për sigurinë e Norvegjisë. Është e rëndësishme për të gjithë rajonin nordik dhe baltik dhe kjo është e rëndësishme për NATO-n”.

Ai tha se të gjithë aleatët, po ashtu edhe Turqia morën një vendim shumë të rëndësishëm në samitin e NATO-s në Madrid vitin e kaluar për të ftuar Finlandën dhe Suedinë të bëhen anëtarë. “E ndërsa Finlanda është bërë tashmë anëtare e plotë, kam besim se edhe Suedia do të bëhet anëtare e plotë. Por ndërkohë, ne duhet të pranojmë se Suedia është në një vend shumë më i fortë dhe më i sigurt tani, sepse sapo u ftuan, ata patën një marrëdhënie të ngushtë me NATO-n përmes statusit të të ftuarit, që do të thotë se Suedia tani po integrohet si në strukturat civile dhe në ato ushtarake të NATO-s. Është absolutisht e paimagjinueshme që të ketë një kërcënim apo sulm kundër Suedisë pa reagimin e NATO-s dhe në krye të kësaj, sigurisht me Finlandën në të njëjtën kohë ajo e bën edhe Suedinë, gjithashtu e garantuar që Suedia po i afrohet edhe më shumë NATO-s. Pra, ne po punojmë për këtë edhe me qëllim që të kemi një vendim në samitin e Vilniusit”. Stoltenberg tha se nuk ka garanci për këtë, por se është absolutisht e mundur të arrihet një zgjidhje dhe të mundësohet vendimi për anëtarësimin e plotë të Suedisë në Samitin e Vilniusit, pasi ka ardhur koha për të ratifikuar procesin e certifikimit, të cilin tashmë e kanë ratifikuar pothuajse të gjithë

aleatët. “Mendoj se është e rëndësishme të kuptojmë se Suedia, si një anëtare e plotë e NATO-s është e mirë për të gjithë Aleancën, të gjithë Aleatët përfshirë Turqinë, dhe ky ka qenë gjithashtu mesazhi im”, - tha Stoltenberg dhe shtoi se, në të njëjtën kohë, Turqia ka shqetësime legjitime për sigurinë. “Asnjë aleat tjetër i NATO-s nuk ka pësuar më shumë sulme terroriste sesa Turqia, dhe fakti që Finlanda, Suedia dhe gjithashtu aleatë të tjerë të NATO-s tani po punojnë më ngushtë se si të shkëmbejnë inteligjencën, informacionin dhe të punojnë së bashku në luftën kundër terrorizmit, është diçka shumë e rëndësishme. Mesazhi im është se është brenda mundësive, është e mundur që Suedia të jetë anëtare e plotë deri në Samitin e Vilniusit, sepse tani ka një dritare, sidomos pas zgjedhjeve turke. Dhe me konstituimin e parlamentit turk sigurisht që është e mundur dhe ne po punojmë shumë që kjo të ndodhë sa më shpejt të jetë e mundur”.

Por NATO do të reagojë nëse dikush do të kërcënonte apo sulmonte Suedinë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se është e paimagjinueshme që nëse ka ndonjë kërcënim apo sulm kundër Suedisë, NATO të mos reagojë. “Kjo është pjesërisht për faktin se Suedia tashmë ka një status shumë të fortë në NATO, sepse meqenëse të gjithë aleatët pranojnë të ftojnë Suedinë, Suedia është integruar gjithnjë e më ngushtë në strukturat tona politike dhe ushtarake. Së dyti, disa aleatë të NATO-s, duke përfshirë më të mëdhenjtë, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca dhe të tjerë, i kanë dhënë Suedisë garanci dypalëshe sigurie si pjesë e procesit të anëtarësimit. Kemi Finlandën si anëtare, kemi Norvegjinë. Kemi jugun, Gjermaninë, Poloninë, Danimarkën. Pra, kjo ide se Suedia ka mbetur vetëm është absolutisht e gabuar. Suedia është shumë afër NATO-s, duke u integruar në strukturat tona. Ka garanci dypalëshe sigurie dhe NATO ka rritur praninë e saj në rajon. Prandaj, ne do të reagojmë nëse ka pasur ndonjë lloj kërcënimi”. Ai shtoi se NATO nuk sheh ndonjë rrezik të afërt ose ndonjë kërcënim sulmi kundër aleatëve të NATO-s ose Suedisë. “Sigurisht që ekziston një rrezik i vazhdueshëm, për sulme të ndryshme kibernetike, hibride, por jo, jo rrezik i lartë për një sulm ushtarak të plotë”, - tha ai.

Ajo që zgjedhim të bëjmë tani përcakton se si do të duket bota në dekadat e ardhshme

Duke folur në Oslo në një ngjarje të bashkë-organizuar nga Komiteti Norvegjez Atlantik dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë (30/05/2023), Stoltenberg tha se “lufta e agresionit të Presidentit Putin kundër Ukrainës shënon fundin e botës siç e dinim”, duke theksuar se “ajo që zgjedhim të bëjmë dhe të mos bëjmë tani do të përcaktojë se si do të duket bota për dekada të tëra”. Ai vuri në dukje se aleatët e NATO-s kanë dhënë kontribute të rëndësishme dhe vendimtare ushtarake dhe se ai pret që të ketë më shumë njoftime dhe vendime të reja në prag dhe në Samitin e Vilniusit në korrik. NATO po punon aktualisht në një program ndihme shumëvjeçarë për Ukrainën, për t’i ndihmuar ato të kalojnë nga epoka e vjetër sovjetike në standardet dhe pajisjet moderne të NATO-s dhe për të ndihmuar Ukrainën të afrohet më shumë me NATO-n. “Ne nuk duhet të lejojmë që presidenti Putin të vazhdojë të shkatërrojë sigurinë evropiane dhe për këtë, ne kemi nevojë për një kornizë që garanton sigurinë afatgjatë të Ukrainës. Nuk mund të parashikojmë rezultatin e diskutimeve, por ajo që është e qartë është se të gjithë aleatët e NATO-s pajtohen që dera e NATO-s është e hapur; të gjithë janë dakord që Ukraina do të bëhet anëtare; dhe të gjithë janë dakord se është Ukraina dhe vendet anëtare të NATO-s që vendosin, jo Rusia. Por gjëja më e rëndësishme tani është që të sigurohemi që Ukraina të mbizotërojë. Kjo është detyra jonë më e rëndësishme. Përndryshe, nuk do të ketë të ardhme për të diskutuar”. Stoltenberg e bëri të qartë gjithashtu se Samiti i Vilniusit do të forcojë më tej parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s. Ai tha se udhëheqësit e NATO-s do të bien dakord për planet e detajuara për mbrojtjen e vendeve aleate. Përcaktimi i kërkesave të sakta për aftësitë që duhet të ofrojnë aleatët individualë dhe cilat forca kërkohen. Ai theksoi se: “E gjithë kjo është pjesë e transformimit dhe forcimit të NATO-s që ka nisur që nga viti 2014, ristrukturimi i NATO-s gjatë dekadës së fundit, për të përgatitur NATO-n për dekadën e ardhshme”. “Në Vilnius, - tha ai, - ne duhet të vendosim një angazhim më të fortë ndaj objektivit 2% të NATO-s. 2% për qind nuk duhet të jenë më tavan që synojmë, por një dysheme mbi të cilën ndërtojmë, një minimum.”

Bajroni për shqiptarët: "S'ka lodhje që mund t'i mposhtë, nuk ka popull më të frikshëm për fqinjët përreth"

“Tek arnautët dhe shqiptarët, - shkruan Bajroni, - më bën përshtypje veçanërisht ngjashmëria me malësorët skocezë, për nga veshja, qëndrimi dhe mënyra e të jetuarit. Malet e tyre më kujtojnë Kaledoninë, me një klimë më pak të egër. Kilti i tyre, megjithëse i bardhë, format e thata dhe të zhdërvjellëta të trupit, dialekti i tyre me bashkëtingëllore si të keltëve, zakonet e tyre luftarake, gjithçka, më sjell ndërmend viset e Morvenit. Nuk ka popull më të urreyer dhe më të frikshëm për fqinjët përreth sesa shqiptarët.

Grekët i shohin si fare pak të krishterë, kurse turqit fare pak si myslimanë. Ndër zakonet e tyre mbizotëron ai i presë, ndaj të gjithë mbajnë armë.

Arnautët, malazezët, himarjotët e gegët janë të njohur për dinakërinë e tyre, ndërkaq pjesa tjetër ndryshon mjaft në zakone, dhe shumë në karakter. Për aq sa munda t'i njoh nuk kam për ta veç lavde...

Kanë një pamje të bukur, ne hasëm midis Delvinës e Libohovës gratë më të adhureshme që kam parë ndonjëherë, ndërsa po rregullonin rrugën e prishur nga përrënjtë. Të ecurit e tyre ka diçka me të vërtetë teatrale, por kjo vjen pa dyshim nga palltoja apo manteli që u varet mbi njërin shpatull.

Flokët e gjata na kujtojnë gratë Spartane, kurse guximi i tyre në luftën partizane kalon çdo cak...

Ndonëse tek grekët ekziston njëfarë kalorësie, nuk kam hasur kurrfarë kalorësie për të qenë tek shqiptarët.

Disa prej tyre preferojnë shalal angleze, por nuk rezistojnë dot për kohë të gjatë. Kurse kur shkojnë më këmbë, s'ka lodhje që mund t'i mposhtë.

Letrat e Bajronit drejtuar nënës së tij, të shkruara në viset shqiptare, dëshmojnë vendbanimet dhe të shkuarën e hershme historike të shqiptarëve deri në Prevezë.

Bajroni ishte një vëzhgues i hollë, ai donte të shtegtonte dhe të eksploronte vendet ku nuk kishin shkuar më parë njerëz të shtresës dhe poezisë së tij, prandaj gjithë udhëtimi i tij ishte në këmbë në tokën e shqiptarëve. Ai i tregoi botës se kishte dëshirë të ishte pranë natyrës dhe njerëzve të thjeshtë, dhe jo më kot, në veprën e Haroldit ka një thirrje shpirtërore, por mjaft komunikuese, ku ai shkruan: “Shqipëri, lejoni të kthej sytë e mi/Mbi ty, o nënë e rreptë burrash t' egër....”, e cila dhe pse ishte e fshehur, ai arriti ta zbulojë me gjithë madhështinë e saj, me bukurinë dhe të vërtetat e saj. Dhe këtë Bajroni i madh e ka kuptuar mjaft mirë, kur ndër të tjera ai shkruan: “Me të vërtetë që unë e kam parë Shqipërinë më shumë se kushdo anglez tjetër, sepse është vend i vizituar rrallë, ndonëse i bollshëm në stoli natyrore. “Në vendet e Ilirisë dhe të Epirit ka vende pa emër dhe lumenj të pa hedhur në hartë, mundet që një ditë, kur të njihen më shumë, të jenë temat më të çmuara e të dorës së parë për penën.”

Me një ndjesi të epërme prej krijuesi gjenial, Bajroni është modeli i shkëlqyer, në shënimet dhe në veprën, e të cilit ai ka arritur të pleksë mjaft mirë shqiptarët, psikologjinë prej luftëtarësh, bujarinë, historinë e tyre, shpirtin e lirë, mprehtësinë dhe aftësinë për të luftuar, trashëgiminë e tyre. Ai shkruan: “Kudo që shohim: rrotull, sipër, poshtë, na lë pa mend magjia ngjyrë ylberi..., të gjithë njerëzit që takuam me fustanellat e bardha përshëndetnin shqiptarçe, ushtarët nuk dallohen nga fshatarët nga veshja, të gjithë mbajnë armë të stolisura... Kur arritëm në Epirin e qemotshëm, afër malit të Tomorrow, u mirëpritëm nga i pari i vendit Ali Pasha.” Ali Pasha rrezaton vlera të jashtëzakonshme në vlerësimin e lordit të njohur anglez, por dhe të poetit të romantizmit, i cili është ndërkohë dhe një luftëtar i lirisë dhe ai vetë.

Bajroni e preku realitetin shqiptar në të gjithë mundësinë që kishte një lord anglez, pasi ai çuditërisht kishte arritur të mësonte se deri ku shtriheshin krahinat shqipfolëse, si provincë e Turqisë Evropiane, por mjaft e rëndësishme për kohën dhe zhvillimet në Ballkan, duke shënuar për këto treva, koordinata të tillë si: “Në perëndim ka gjirin e Venecias, në lindje Maqedoninë, Thesalinë dhe Greqinë. Ndërsa në jug mbërrin deri në gjirin e Lepantos ose, gjiri i Artës”, për ta përmbushur me mjeshtëri dhe një dashuri të pakufishme me përshkrimin e Shqipërisë së jugut, veçmas Çamërinë, ku ndrisin dhe kumbojnë vargjet për Marko Boçarin dhe suljotët e përqendruar në lindje të Paramithisë: “Kush ia shkon në trimëri suljotit brun/Me të bardhë fustanellë e me gunë”, dhe që kishte kaq shumë vlera në kontekstin e gjerë shqiptar, kur shkruante: “O Shqipëri, ku lindi Iskanderi, këngë e trimërisë, fanar i të urtëve./Dhe Iskanderi tjetër që i tmerroi armiqtë me kordhën e tij kreshnike” (Iskanderi tjetër, ndryshe Aleksandri i Maqedonisë).



Në vlerësimin e Bajronit ka një dëshmi të mrekullueshme për burrat shqiptarë, kryesisht ata të Shqipërisë së Jugut dhe njerëzve të Ali Pashë Tepelenës. Është një përshkrim gati autentik i përpiktë, duke i përshkruar si “trupa shumë të mirë, nuk shquhen si kalorës, por në këmbë janë të palodhur dhe shumë të duruar. Armën kur e hedhin supit të djathtë e mbajnë pa asnjë sforcim, ndërsa vrapojnë përpjetë maleve të tyre me lehtësi e zhdërvjelltësi. Ndoshta janë raca më e bukur në botë”, përkundër të cilëve shquajnë tiparet e grave shqiptare, se “... edhe gratë janë të hijshme, vajzat arnautë janë shumë të bukura

dhe kostumi i tyre është shumë piktoresk. Ato edhe hijeshinë e trupit e ruajnë më gjatë pasi rrojnë përjashta në ajër të lirë. Ato bëjnë jetë patriarkale, por kjo ndrydheje e përkohshme e personalitetit të tyre u duket e natyrshme, madje u jep krahë për të gjetur kuptimin e jetës në dashurinë dhe detyrën amtare. Janë po ato gra që në raste rreziku e nevojë shkojnë në luftë përkrah burrave dhe kurrë nuk dorëzohen për të mbrojtur nderin e tyre... Ishin gratë e fshatit Dhoksat që ndërtuan urën e prishur nga përroi i rrëmbyer, kur morën vesh se do të kalonim ne në udhën e bllokuar nga gurët”, shënon në shënimet e tij romantiku Xhorxh Bajroni.

Kultura dhe mjediset shqiptare të kohës, kurrë nuk kanë pasur një tablo kaq të gjerësishme në letërsinë e kohës. Bajroni e ka madhështuar gjithashtu Ali Pashë Tepelenën, jo vetëm në takimin me të, për të cilin ai shkruan: “Të nesërmen më shpunë tek Ali Pasha. Isha veshur me uniformë të plotë shtabi, me shpatë madhështore... Më prit në këmbë, shenjë e një nderimi të madh nga një mysliman dhe më vuri të rri në shesh në krah të djathtë të tij... E para pyetje që më bëri ishte, se përse jam larguar prej atdheut në një moshë kaq të re, pastaj, tha se ministri anglez, kapiteni Lake, i kishte treguar se qeshë nga derë e madhe... Më tha, se qe i bindur se isha prej oxhaku, se kisha veshë të vegjël, flokë kaçurrela dhe duar të vogla të bardha, dhe u duk shumë-shumë i kënaqur nga pamja ime...”, ndërsa pashain gjëmëmadh të Tepelenës e përshkruan: “Naltësia e tij është gjashtëdhjetë vjeç, shumë i ngjallur dhe jo shtatmadh, por ka një fytyrë të hijshme, sy të larmë, dhe mjekër të bardhë, shumë i pritshëm dhe sillet me atë farë sedre që më ngjall, se është veti e të gjithë turqve. Por karakterin e vërtetë e ka fare të ndryshëm nga ç' duket në fytyrë. Është tiran pa shpirt, i ngarkuar me mizoritë më të tmerrshme, shumë trim dhe aq gjeneral i mirë, sa e quajnë Bonaparti muhamedan...”, por ndërkohë Ali Pashë Tepelena mbeti miku i tij më i madh dhe më i afërt.

Një copëz Shqipëri e ardhur prej rrënojash historike do të vazhdojë të risjellë në kujtesën e saj, në shtypin ushtarak rëndësinë e madhe të një populli të vogël, por të vlerë, ku dimensionet kulturore, morale dhe patriotike ndër shekuj kanë çuditur këdo që ka pasur fatin t'i njohë, shpesh të pakuptimtë për kulturën që trashëgon.



1 Qershori i buzëqeshjes hyjnore

Dita e Fëmijëve shënohet më 1 qershor në mbarë botën.

Kjo ditë nuk është vetëm ditë festive, por njëherësh 1 qershori shërben për të sensibilizuar dhe për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojëra festive.

Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqenies së Fëmijëve në Gjenevë, në 1925. Në të njëjtën ditë, konsulli i përgjithshëm kinez në San Francisko mblodhi së bashku një numër të konsiderueshëm fëmijësh jetimë kinezë të festonin në festivalin e "Anijes së Dragoit".

Dy vite më pas festa e 1 qershorit filloi të festohet në të gjithë botën.

Në Shqipëri, por edhe në të gjithë vendet e botës, fëmijët kanë ditën e tyre të festës. Nuk do të mungojnë edhe aktivitetet e larmishme që do të organizohen për ta bërë këtë ditë sa më të bukur për të vegjlit.

Përveçse një ditë festive, 1 Qershori është edhe një ditë sensibilizimi për të ndaluar dhunën dhe abuzimin me fëmijët, sidomos angazhimin e tyre në punë kur janë ende të mitur.

UNICEF që prej vitit 1950, punon në 190 vende të botës me familjet, bashkësitë dhe qeveritë për të garantuar të drejtat e fëmijëve. Që prej 1989, shumë qeveri kanë adoptuar Konventën e OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve, e cila garanton zbatimin dhe respektimin e të drejtave të barabarta për çdo fëmijë, me qëllim plotësimin e nevojave të tyre për mbijetesë, rritje, pjesëmarrje dhe përmbushjen e potencialit të tyre. Megjithatë, ende miliona fëmijë në botë janë pre e dhunës, abuzimit dhe diskriminimit, dhe shumë të tjerë nuk iu garantohet shëndeti, ushqimi, streha, shkollimi apo shfrytëzohen, duke lypur apo punuar për të tjerë.

Si ka qenë 1 Qershori dje dhe si është sot?

Nëse do të kthehemi kohë më parë, atëherë kur fëmijët luanin kudo në lagje dhe shpesh me ta bashkoheshin edhe prindërit, do të shohim se festimet më të mëdha nuk i kapërcenin ato të një organizimi në shtëpi. Pra vogëlushët mblidheshin në shtëpinë e njërit prej tyre dhe festonin, duke kërcyer këngë fëmijësh, ndoshta kush frekuentonte kopshtin kishte mundësinë të shijonte edhe organizimet e bëra në këtë institucion, më pas një akullorë apo kokoshkë dhe shëtitje me prindërit. Kush ishte me më shumë fat merrte tek-tuk edhe ndonjë dhuratë simbolike, e cila nuk konsiderohej si një kusht i domosdoshëm.

Po sot?

E kush e mendon 1 Qershorin pa dhuratë? Mjafton të shkoje në një dyqan lodrash të një qendre tregtare dhe mund ta provoje pa asnjë problem këtë dukuri. Prindër që shtynin karroca të mëdha të mbushura plot me lodra nga më të bukurat, disa mbanin pranë edhe fëmijët



1 QERSHORI SHËRMBEN PËR TË SENSIBILIZUAR DHE PËR T'I THËNË JO DHUNËS DHE ABUZIMIT NDAJ FËMIJËVE. ËSHTË DITA KUR VETË FËMIJËT NGRENË ZËRIN PËR TË DREJTAT E TYRE, POR NË NDRYSHIM NGA TË RRIURIT, PROTESTA E TYRE BËHET ME LOJËRA FESTIVE.

që me shumë kujdes bënin zgjedhjet e tyre dhe më pas të gjithë drejtoheshin tek arka. Por nuk mbaronte gjithçka atje. Më pas do të vinte shëtitja edhe pse gjatë pjesës tjetër të ditës festa do të ishte zhvendosur në kopsht. Nuk bëhej fjalë për një festë dosido! Bëhej fjalë për një nga ato festat e mëdha, e organizuar

nga një agjenci eventesh, me animatorë e personazhe të ndryshme, dhe vogëlushët dukeshin se po e shijonin pa masë.

Ka diçka të gabuar tek festimet e sotme?

Nëse do ta shikojmë me vëmendje atë që ndodh me festimet e ditëve të sotme do të kuptojmë se ka disa faktorë

që e kthejnë atë në një ditë disi edhe të frustruar për fëmijën.

Fëmija nuk ka nevojë për festime madhështore për të qenë i lumtur dhe kjo jo vetëm gjatë ditës së 1 Qershorit? E keni menduar ndonjëherë se për të do të ishte më tepër argëtuese të shkonte për një piknik në natyrë dhe jo brenda

një arene lojërash pa fund?

E keni menduar ndonjëherë rëndësinë e natyrës në zhvillimin e fëmijës?

Ai ka nevojë të prekë barin, të shikojë edhe insektet e vogla që lëvizin me aq lezet, e madje edhe të mundohet t'i kapë, edhe pse është 1 Qershori.

Ndoshta ajo është mënyra më e mirë që ai të festojë ashtu si do ai!

Ajo është dita e fëmijëve dhe ndoshta duhet të përpiqemi të gjithë si prindër t'i bëjmë fëmijët të argëtohen në një mënyrë më tepër spontane, më të thjeshtë, më të çiltër ashtu siç është edhe vetë bota dhe shpirti i fëmijës.

Gëzuar 1 Qershorin fëmijë të dashur dhe ju fëmijë të rritur me fëmijërinë e përjetshme brenda jush!



Konfiskimi i aseteve kriminale në të gjithë BE-në, më i shpejtë dhe më efikas

Legjislacioni i ri për sekuestrimin e aseteve kriminale do të sigurojë operacione të shpejta dhe efikase të ngrirjes kudo në BE dhe kompensim më të shpejtë për viktimat.

Për të përshpejtuar ngrirjen dhe konfiskimet e pasurive dhe për të mbyllur boshllëqet, eurodeputetët në Komitetin e Lirive Civile, Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, miratuan të martën një projekt-pozicion për rregullat e reja me 50 vota pro, 1 kundër dhe 4 abstenime. Negociatat e Trilogut u autorizuan me 53 pro, 0 kundër dhe 2 abstenime.


Krahasuar me legjislacionin ekzistues, direktiva e re do të mbulojë gjithashtu trafikun e armëve të zjarrit, disa krime të kryera si pjesë e një organizate kriminale dhe shkeljen e sanksioneve të BE-së. Në pozicionin e tyre, eurodeputetët propozojnë që të përfshihet edhe trafikimi i paligjshëm i materialit bërthamor, krimet që janë në juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, sekuestrimi i paligjshëm i avionëve dhe anijeve dhe sabotimi.

Teksti i rënë dakord do të mbyllte zbrazëtitrat duke siguruar që asetet mund të ngrihen shpejt, me masa të përkohshme urgjente aty ku është e nevojshme. Propozimi gjithashtu do të godasë ata që i shmangen konfiskimit me ndihmën e një personi të tretë dhe do të lejojë konfiskimin në raste të caktuara, kur dënimi nuk është i mundur, për shembull në rastet e sëmundjes ose vdekjes së një të dyshuari.

Për t'i bërë hetimet ndërkufitare më efikase, ligji do të harmonizonte kompetencat e zyrave të rikuperimit të aseteve të ngritura nga shtetet anëtare, duke siguruar që ato të kenë akses në informacionin e nevojshëm, si regjistrat e pronësive përfutuese, informacionin për letrat me vlerë dhe monedhën, të dhënat doganore dhe financiare vjetore dhe deklaratat e kompanive. Së fundi, për të parandaluar degradimin e aseteve, shtetet anëtare do të duhet të krijojnë zyra të dedikuara për të menaxhuar pasuritë e konfiskuara.

Eurodeputetët dëshirojnë gjithashtu të sigurojnë që viktimat të kompensohen përpara konfiskimit, veçanërisht në rastet ndërkufitare, dhe të lejojnë që asetet e konfiskuara të përdoren për qëllime të interesit social ose publik.

Pas votimit, raportuesi Loránt Vincze (EPP, Rumani) tha: “Është shumë e rëndësishme që kriminelët të privohen nga përfitimet e tyre, të kufizohen kapacitetet e tyre për t'i riinvestuar ato në ekonominë ligjore dhe për t'u siguruar që përfshirja në aktivitete kriminale nuk paguan. Raporti zgjeron fushëveprimin e direktivës në krime të tjera përkatëse, forcon autoritetet kompetente në identifikimin, ngrirjen dhe menaxhimin e aseteve, zgjeron aksesin që kanë zyrat e rikuperimit të aseteve në bazat e të dhënave përkatëse, i jep përparësi kompensimit të viktimave dhe përmirëson bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përkatëse dhe agjencive të BE-së.



Komiteti Evropian i Rajoneve dhe UNICEF bashkojnë forcat për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve nga Ukraina

Të dy organizatat do të mbështesin administratat lokale dhe rajonale për të zbatuar masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe integrimin social.

Komiteti Evropian i Rajoneve (CoR) dhe UNICEF kanë nënshkruar një marrëveshje për të mbështetur administratat rajonale dhe lokale në Bashkimin Evropian në punën e tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe promovimin e Garancisë Evropiane për Fëmijët me fokus fëmijët refugjatë nga Ukraina.

Më konkretisht, marrëveshja synon të lehtësojë shkëmbimin e njohurive midis Korporatës së Korporatës, UNICEF-it dhe autoriteteve lokale dhe rajonale se si të hartohen, koordinohen dhe zbatohen më së miri programet për fëmijët refugjatë nga Ukraina, me një vështrim në integrimin e tyre afatgjatë në qytetet evropiane dhe rajone.

Kjo nismë e përbashkët do të bazohet gjithashtu në punën legjislative të Komitetit Evropian të Rajoneve – asamblesë politike të BE-së për politikanët lokalë dhe rajonalë – për të siguruar të drejtat e fëmijëve në ligjin e BE-së, duke përfshirë Garancinë Evropiane të Fëmijëve të miratuar nga BE në 2021. Legjislacioni ofron udhëzime dhe mjete për vendet e BE-së në mënyrë që çdo fëmijë në Bashkimin Evropian në rrezik nga varfëria ose përjashtimi social të ketë akses në arsimin, kujdesin shëndetësor, ushqimin dhe strehimin e duhur deri në vitin 2030. Shumë nga shërbimet publike që janë kritike për arritjen e këtyre objektivave drejtohen nga administratat lokale dhe rajonale.

Më shumë se 8.2 milionë njerëz – shumica e të cilëve janë gra dhe fëmijë – kanë ikur nga lufta kundër Ukrainës në vendet fqinje, ku shumë prej tyre kanë vazhduar udhëtimin e tyre drejt destinacioneve të tjera. Autoritetet nën-kombëtare evropiane kanë treguar solidaritet të paprecedentë në pritjen e fëmijëve refugjatë dhe familjeve nga Ukraina.

Vasco Alves Cordeiro (PT/PES), President i Komitetit Evropian të Rajoneve, tha: “Që nga sot, është zyrtare që Korniza dhe UNICEF bashkojnë forcat në një partneritet të ri për të rritur mbështetjen për qytetet dhe rajonet e BE-së në punën e tyre, mbi mbrojtjen e fëmijëve, me fokus të veçantë për fëmijët nga Ukraina. Kjo marrëveshje partneriteti tregon përkushtimin e Korporatës në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë edhe më të cenuarit. Falë këtij bashkëpunimi të ri, ne do të jemi në gjendje të lehtësojmë shkëmbimet ndërmjet UNICEF-it dhe KE-së. Anëtarësimi i Ekspertizës teknike të UNICEF-it do të jetë thelbësor për të garantuar që autoritetet lokale dhe rajonale të zbatojnë standardet e duhura për akomodimin, integrimin dhe arsimimin e fëmijëve. Veçanërisht rajonet e largëta dhe qytetet e



vogla, të cilët mirëpresin fëmijët e zhvendosur, por nuk kanë shumë përvojë ose lidhje të ngushta me Ekspertët ndërkombëtarë të kujdesit ndaj fëmijëve, do të përfitojnë nga shkëmbimet e ardhshme. Autoritetet lokale dhe rajonale mbajnë një përgjegjësi të madhe dhe po tregojnë solidaritet të jashtëzakonshëm kur mirëpresin fëmijët e zhvendosur. Kjo është arsyeja pse ne e njohim sot punën e UNICEF-it dhe autoriteteve lokale dhe rajonale në Evropë, të gatshëm për të përmirësuar stafin e tyre, për të përmirësuar objektet e tyre dhe për t'i bërë qytetet dhe rajonet e tyre një vend edhe më mikpritës për fëmijët e cenueshëm dhe refugjatë.”

Philippe Cori, Drejtor Rajonal i UNICEF-it për Evropën dhe Azinë Qendrore, tha: “Fëmijët dhe familjet nga Ukraina kanë duruar më shumë se një vit luftë dhe shpërngulje. Sigurimi që fëmijët të jenë në një mjedis të sigurt ku ata mund të luajnë, të mësojnë dhe të ndërveprojnë me bashkëmoshatarët e tyre është thelbësor për mirëqenien e tyre. Administratat lokale dhe rajonale luajnë një rol jetik në përmirësimin e shërbimeve dhe promovimin e kohezionit social. Nëpërmjet këtij partneriteti, UNICEF do të mbështesë autoritetet lokale për të forcuar sistemet e tyre për mbrojtjen e fëmijëve në nevojë, përfshirë fëmijët refugjatë nga Ukraina.”

Në qershor të vitit 2022, Projekti dhe shoqatat territoriale nga Ukraina dhe BE krijuan Aleancën Evropiane për Qytetet dhe Rajonet për Rindërtimin e Ukrainës, e cila do të kontribuojë në rindërtimin e infrastrukturës publike, përfshirë shkollat. KR po shërben si sekretariat i Aleancës.



Zjarret: BE dyfishon flotën e zjarrfikësve të shpëtimit të BE-së për verën e 2023

Pas fjalimit të Presidentit von der Leyen për Gjendjen e Bashkimit në shtator të vitit të kaluar, komisioneri për menaxhimin e krizave Janez Lenarčič njoftoi sot dyfishimin e flotës ajrore të shpëtimit të zjarrfikësve të shpëtimit të BE-së për sezonin e zjarrit të këtij viti, ndërsa fliste në 10-vjetorin e Qendrës së Koordinimit të Reagimit Emergjent të BE-së.

Flota e zjarrfikësve rescEU për vitin 2023

Rezerva e avionëve zjarrfikës të rescEU përfshin 24 aeroplanë dhe 4 helikopterë nga 10 shtete anëtare: Dy aeroplanë me tërheqje të mesme nga Kroacia; Dy avionë të lehtë nga Qipro; Dy helikopterë nga Çekia; Dy aeroplanë me tërheqje të mesme dhe një helikopter nga Franca; Dy avionë të lehtë nga Gjermania; Dy aeroplanë me fushëveprim mesatar, dy avionë të lehtë dhe një helikopter nga Greqia; Dy avionë me fushëveprim të mesëm dhe dy avionë të lehtë nga Italia; Dy avionë të lehtë nga Portugalia; Dy aeroplanë me tërheqje të mesme nga Spanja; Katër avionë të lehtë nga Suedia.

Përveç kësaj, Austria, Bullgaria, Finlanda, Franca, Gjermania, Letonia, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia do të dërgojnë pothuajse 450 zjarrfikës për t'u paravendosur në Francë, Greqi dhe Portugali.

Masat parandaluese dhe monitoruese

Pas thirrjeve të ministrave të BE-së dhe Parlamentit Evropian, në vitin 2022 Komisioni zhvilloi gjithashtu një Plan Veprimi për Parandalimin e Zjarrit. Ky plan veprimi është i organizuar rreth tre objektivave: 1) përmirësimi i kapaciteteve administrative; 2) të përmirësojë njohuritë; 3) rritja e investimeve në aksionin për parandalimin e zjarreve.

Si pjesë e planit të veprimit për parandalimin, BE-ja po lançon një Metodologji të re të Vlerësimit të Rishikimit kolegjial të Zjarrit. Ky mjet i ri i ndihmon vendet të vlerësojnë kapacitetin e tyre për të parandaluar dhe përgatitur për zjarret, si dhe mbështet shkëmbimin e praktikave të mira midis vendeve evropiane, brenda kuadrut të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.

Për më tepër, është duke u krijuar një ekip mbështetës i Qendrës së Koordinimit të Reagimit ndaj Emergjencave për Zjarret e Egra për të mundësuar monitorimin dhe analizën në kohë reale të situatës së zjarrit nga mesi i qershorit deri në mes të shtatorit.

Veprimet e parandalimit, gatishmërisë dhe reagimit ndaj zjarreve të egra punojnë krah për krah për të shpëtuar jetë, mjete jetese dhe për të mbrojtur mjedisin. Të kesh në dispozicion ekspertë me përvojë të zjarreve, zjarrfikës të trajnuar mirë, teknologji informacioni dhe mjete të mjaftueshme reagimi bën ndryshim.

BE-ja siguron një qasje të koordinuar për parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj zjarreve kur ato mposhtin kapacitetet kombëtare të reagimit. Kur shkalla e një zjarri të egër tejkalon aftësitë e reagimit të një vendi, ai mund të kërkojë ndihmë nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Pasi aktivizohet, Qendra e Koordinimit të Reagimit Emergjent të BE-së koordinon dhe financon ndihmën e vënë në dispozicion nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe nëntë Shtete të tjera Pjesëmarrëse nëpërmjet ofertave spontane. Përveç kësaj, BE-ja ka krijuar Pishinën Evropiane të Mbrojtjes Civile për të pasur një numër kritik të kapaciteteve të disponueshme të mbrojtjes civile që mundësojnë një përgjigje kolektive më të fortë dhe koherente. Nëse urgjenca kërkon ndihmë shtesë për shpëtimin e jetës, rezerva e zjarrfikësve ‘rescEU’ ndërhyr për të siguruar kapacitete shtesë për t'u përballur me fatkeqësitë në Evropë. Qendra e Koordinimit të Reagimit Emergjent monitoron gjithashtu evolucionin e zjarreve me mbështetjen e sistemeve të paralajmërimit të hershëm si Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret në Pyje, ndërsa shërbimi i hartës satelitore emergjente ‘Copernicus’ i BE-së plotëson operacionet me informacion të detajuar nga hapësira.

A ka një rol OKB-ja në Chatbot-in e Inteligjencës Artificiale?

Kur OKB-ja shfaqti një robot femër në shkurt 2019, ishte një vështrim në të ardhmen: një teknologji dixhitale me ritme të shpejta dhe më të avancuara ku njerëzit një ditë mund të zëvendësohen me makina dhe robotet.

Megjithatë, një shaka që qarkullonte në sallën e delegatëve të OKB-së në atë kohë ishte mundësia, ndoshta në një të ardhme të largët, të një roboti - një robot femër - si Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së në një organizëm botëror i cili ka qenë i dominuar nga nëntë sekretarë të përgjithshëm, të gjithë meshkuj, gjatë 78 viteve të fundit.

A do të duhet një robot për të thyer atë traditë jo të shenjtë?

Në një takim të përbashkët të Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së (ECOSOC) dhe Komitetit të tij Ekonomik dhe Social, roboti i quajtur Sophia pati një seancë interaktive me zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm Amina J. Mohammed.

Por me përparimet e pabesueshme në chatbot-it CHATGPT - motori i kërkimit të AI-së është tani i aftë të prodhojë tekste, artikuj, fjalime, postime, email-e, dhe madje edhe një libër të tërë.

Nëse OKB-ja është plotësisht e aftë për teknologjinë, a do të ndihmojë chatbot-i i AI-së në prodhimin e raportit vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm, plus raporte dhe njoftime për shtyp nga komitetet e OKB-së dhe agjencitë e OKB-së?

Por rreziqet dhe të metat e natyrshme në robotin e bisedës AI, përfshijnë dezinformimin, shtrëmbërimet, gënjeshttrat dhe gjuhën e urrejtjes - jo domosdoshmërisht në atë renditje. Më keq akoma, motori i kërkimit nuk mund të bëjë dallimin midis faktit dhe trillimit.

Duke dëshmuar para Kongresit të SHBA-ve, më 16 maj, Sam Altman, shefi ekzekutiv i 'OpenAI' u kërkoi ligjvënësve të rregullonin AI-në.

Ian Richards, ish-President i Komitetit Koordinues të Sindikatave dhe Shoqatave Ndërkombëtare të Stafit, (CCISUA) i tha IPS-së: "AI-ja është e mirë në rigjenerimin e asaj që gjen në internet dhe që është vendosur nga dikush, pavarësisht nëse është e saktë apo jo. Në thelb, riprodhon modelet ekzistuese". "Megjithatë, puna jonë ka dy pjesë", - theksoi ai.

Pjesa interesante, me vlerë të lartë të shtuar përfshin bisedën me njerëzit në terren në zona të largëta, mbledhjen e historive, eliminimin e paragjyimeve dhe krijimin e të dhënave nga burime që janë jashtë linje ose jo të besueshme. Kjo është



diçka që AI-ja do ta kishte të vështirë ta bënte, shtoi ai.

Pjesa më pak interesante dhe

me vlerë të ulët të shtuar përfshin krijimin e tabelave dhe grafikëve, kryerjen e llogaritjeve të përsëritura

dhe formatimin e dokumenteve, vuri në dukje ai.

"Nëse AI-ja mund të marrë

përsipër disa nga këto të fundit dhe të na japë më shumë kohë për t'u përqendruar në të parën, stafi do të jetë edhe më produktiv dhe më i lumtur", - tha Richards, një ekonomist zhvillimi në Konferencën e OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin me qendër në Gjenevë (UNCTAD).

"Por le të mos përfshihemi shumë në zhurmë. Dhe çdo anëtar i stafit që mbështetet shumë në AI për të prodhuar përmbytje origjinale do të kapet shpejt", - tha ai.

Javën e kaluar 'New York Times', - citoi Gary Marcus, profesor emeritus i psikologjisë dhe shkencës nervore në Universitetin e Nju Jorkut (NYU), duke bërë thirrje për një institucion ndërkombëtar për të ndihmuar në qeverisjen e zhvillimit dhe përdorimit të AI-së.

"Unë nuk jam një nga ata rrezikues afatgjatë që mendojnë se i gjithë planeti do të pushtohet nga robotët. Por jam i shqetësuar se çfarë mund të bëjnë aktorët e këqij me këto gjëra, sepse nuk ka kontroll mbi to", - paralajmëroi ai.

Ndërkohë, disa nga risitë teknologjike që po eksperimentohen aktualisht në OKB përfshijnë mësimin e makinerive, përkthimet elektronike (duke përfshirë gjashtë gjuhët zyrtare të OKB-së, ku makinat kanë marrë kontrollin nga njerëzit) dhe robotikën.


Kombet e Bashkuara thonë se kanë përdorur gjithashtu mjete ajrore të paarmatosura dhe pa pilot (UAV), ose dronë, në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, duke ndihmuar në përmirësimin e ndërgjegjësimit tonë për situatën dhe për të forcuar aftësinë tonë për të mbrojtur civilët.

Ndër risitë teknologjike që prezantohen në organizmin botëror, dhe veçanërisht në shërbimet e E-konferencave të OKB-së, është përdorimi i 'eLUNA - Electronic Languages', një ndërfaqe përkthimi me makinë, e zhvilluar posaçërisht për përkthimin e dokumenteve të OKB-së".

Ajo që e dallon 'eLUNA-n' nga mjetet komerciale CAT (Përkthimi i Asistuar nga Kompjuteri) është se ai u zhvillua tërësisht nga Kombet e Bashkuara dhe është i orientuar në mënyrë specifike për nevojat dhe metodat e punës të profesionistëve të gjuhës së OKB-së, thonë përfaqësues të OKB-së.

I pyetur nëse OKB-ja duhet të ketë një rol në debatin në rritje mbi AI-në, zëdhënësi i OKB-së, Stephane Dujarric u tha gazetarëve, më 22 maj: "Unë mendoj se kjo është një çështje për të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka shprehur shqetësimin ekstrem, mungesa e rregullores, mungesa e masave mbrojtëse, veçanërisht kur

Ndoshta duhet një agjenci e re e ardhshme e OKB-së për AI-në?



bëhet fjalë për armët autonome. Dhe unë mendoj se ai ka qenë shumë i qartë për këtë. Është një nga gjërat që e mban zgjuar gjatë natës... ne duhet të publikojmë së shpejti dokumentin tonë të fundit të politikave mbi kompaktin global dixhital."

Duke iu referuar inteligjencës artificiale dhe mediave sociale, ai tha: "Këto janë gjëra që duhen trajtuar, brenda asaj që ne duam t'i referohemi si mjedise me shumë palë të interesuara, sepse është e qartë se në këtë drejtim, fuqia nuk është vetëm në duart e qeverive, është shumë edhe në

sektorin privat. Dhe OKB-ja ka qenë dhe do të vazhdojë të përpiqet t'i sjellë të gjithë këta njerëz në tryezë."

Duke iu përgjigjur pyetjeve nëse Guterres planifikon të thërrasë një konferencë ndërkombëtare për AI-në, zëvendës zëdhënësi i OKB-së, Farhan Haq tha: "Nuk kam një takim për të njoftuar tani për tani, por sigurisht, këto janë pjesë e shqetësimeve që ka vetë Sekretari i Përgjithshëm, është shprehur ideja se, ndërsa intelijenca artificiale zhvillohet, ajo duhet të monitorohet me kujdes dhe duhet të vendosen rregulloret dhe standardet e duhura për t'u siguruar

që kjo lloj teknologjie nuk është e hapur për abuzim".

I pyetur nëse ka ndonjë shans që Sekretari i Përgjithshëm mund të konsiderojë thirrjen e një konference ndërkombëtare për AI-në, Haq tha: "Kjo është sigurisht diçka që mund të merret parasysh. Natyrisht, nëse ai beson se ky do të ishte një hap i dobishëm përpara."

Duke folur në kushte anonimiteti, një punonjës i OKB-së vuri në dukje se OKB-ja dikur provoi një sistem AI për të gjeneruar transkriptet për takimet.

Por në një rast, ai citoi gabimisht një delegat të Bashkimit Evropian (BE) që fliste për "pushtimin ligjor rus të Ukrainës" dhe një delegat tjetër që akuzonte Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) për krijimin e një konflikti në Etiopinë Veriore.

Morali i historisë është se AI-ja duhet të monitorohet nga afër dhe të kontrollohet dyfish, sepse mund të prodhojë informacion të pasaktë dhe të shtrëmbërojë fakte dhe shifra.

Në një takim në Shtëpinë e Bardhë, më 4 maj, mes drejtuesve nga 'Google', 'Microsoft', 'Anthropic' dhe 'OpenAI', krijuesi i ChatGPT, Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden përcolli ndjenja të përziera: "Ajo që po bëni ka një potencial të madh dhe rrezik të madh".



Federata panshqiptare e Amerikës, “Vatra”, po e ndiqte me shqetësim teatrin e zhvillimeve luftarake gjatë Luftës së Parë Botërore, veçanërisht në Ballkan, ku fqinjët kishin synim të copëtonin Shqipërinë. Vatranët nuk qëndruan duarkryq. Që më 1916, “Vatra” nisi organizimin e shërbimit diplomatik, duke i vënë një rrogë mujore prej rreth 1600 frangash delegatit të saj në Londër, Mehmet Bej Konicës, duke e emëruar ambasador (apo delegatë të Vatrës), Mithat Frashëri, Dr. Mihal Turtulli etj. Pagesa sigurohej përmes organizimit të “Dita e delegatit”. Po ashtu, gjatë vitit 1916 nisën pranë degëve të mëdha përgatitjet e trupave vullnetare të Vatrës për të qenë të gatshëm për mbrojtjen e kufijve jugorë.

“Vatra” dhe miqtë e saj në Europë e Washington po mendonin se si ta shpëtonin pavarësinë që realisht nuk ekzistonte më, mundësisht të kthenin territoret e humbura nga Konferenca e Londrës. Fundi i luftës nuk duhej ta gjente të papërgatitur Vatrën. Këtij qëllimi i shërbeu fushata e madhe për shpëtimin e Shqipërisë, e cila synonte për të organizuar lobimin dhe mbrojtjen e Shqipërisë.

3 qershori i vitit 1917, ka hyrë në historinë kombëtare si “Dita e shpëtimit të Shqipërisë nga shqiptarët e Amerikës”.

Shkak për lëvizjen shpëtimtare ishte raporti që Mehmet Konica, delegati i Vatrës për Evropën, me qendër në Londër, i dërgoi Vatrës në Boston, si dhe një letër mallëngjyese e delegatit tjetër të Vatrës në Gjenevë, Dr. Mihal Turtulli. Komisioni qendror i Vatrës, që në atë kohë drejtohej nga kryetari Kolë Tromara dhe sekretari Loni Kristo, mori në shqyrtim raportin dhe letrën në mbledhjen e pasdites të së dielës të 20 majit 1917. Raporti i Mehmet Konicës u hapi sytë vatranëve për gjendjen reale ku ishte Shqipëria, e kthyer në shesh lufte dhe pre e fqinjëve, që kërkonin t’i zhvatnin të tjera territore, në ato vite kaotike të Luftës së Parë Botërore. Përveç humbjeve të territoreve, që i kishte shkaktuar Konferenca e Londrës, paslufta shtonte pikëpyetjet për ekzistencën e më pastajme. Ndërsa letra mallëngjyese e delegatit të Vatrës në Zvicër, Dr. Mihal Turtulli, që shoqërohej edhe me njëmijë dollarë, ishte një thirrje që preku thellë zemrat e vatranëve.

Komisioni Qendror i Vatrës, pasi e lexoi letrën e Dr. Turtullit dhe raportin e delegatit Mehmet Bej Konica, arriti në përfundimin se “Vatra” do të mbetej përgjithnjë e turpëruar në sytë e botës, po të mos i përgjigjej pozitivisht thirrjes për të nisur fushatën shpëtimtare.

“Po! - iu përgjigjen vatranët thirrjes, - ashtu si ua do nderi,

3 qershori i vitit 1917, “Dita e shpëtimit të Shqipërisë nga shqiptarët e Amerikës”

trimërisht dhe me dorën hapur”, - u shkrua në rekordin e mbajtur, më 20 maj 1917.

Propozimi i Dr. Turtullit ishte që të mblidheshin së paku nja 40 mijë dollarë, që do të përdorreshin për shpëtimin e Shqipërisë, duke ngritur një Komision Shpëtimi.

Në mbledhjen e 20 majit, Komisioni Qendror vendosi që të caktohej e diela e 3 qershorit 1917, për të nisur fushatën e madhe të shpëtimit të Shqipërisë, duke synuar mbledhjen e 40 mijë dollarëve, sa ç’ propozonte Dr. Turtulli. Ftoheshin të gjitha degët e Federatës Pan shqiptare të Amerikës, “VATRA”, të gjitha shoqëritë shqiptare, të gjitha shoqëritë fetare, kombëtare dhe të gjithë shqiptarët e Amerikës, që të bëheshin bashkë në qendrat, ku jetonin dhe, nën moton “Të shpëtojmë Shqipërinë!” të jepnin kontribute sipas mundësive por, pa u kursyer. U ftuan gazetat dhe revistat shqiptare, të shpërndanin këtë mesazh kombëtar dhe të kontribuonin nën frymën e Rilindjes. Në thirrje ftoheshin shqiptarët e Amerikës që, së paku, të jepnin 10 dollarë e sipër për këtë fushatë.

Komisioni Qendror i Vatrës orientoi delegatin Mehmet bej Konica në bashkëpunim me Dr. Mihal Turtullin, të organizonin Komitetin e Shpëtimit Kombëtar në bashkëpunim me shqiptarët e Amerikës.

Vendimet u përcollën përmes mikut të sprovuar të shqiptarëve z. Aubrey Herbert. Në atë kohë Komisioni Qendror i Vatrës përbëhej nga këta atdhetarë:

Kolë Tromara - Kryetar i Vatrës, Loni Kristo - Sekretar, Bahri Omari ishte kryeredaktor i Diellit; Xhevat Harxhi, Aqif Përmeti, Emin Bilibashi dhe Fan S. Noli, ishin kontrollorë.

LETRA QË NGRITI PESHË SHQIPTARËT E AMERIKËS

“Vatra” hartoi një letër-qarkore, firmosur nga Kolë Tromara dhe Loni Kristo, që ia adresuan të gjitha degëve të Vatrës (në atë kohë numëroheshin rreth 80 degë), shoqërive shqiptare, fshatare, fetare dhe patriotike, që vepronin në SHBA. Në atë letër informoheshin shqiptarët se Atdheu ishte në rrezik të humbte pavarësinë e 1912-ës, prandaj kërkohej bashkim për ta shpëtuar Shqipërinë.

Letër-qarkorja nuk linte hapësirë për diskutim. Në të shkruhej shkoqur:

“Komisioni kërkon nga atdhetarët e Amerikës një gjë, për një qëllim, mbi të cilin s’ka bisedim.”...

Pra gjithçka ishte e vendosur, shuma duhej mbledhur medoemos. Komunikimi ishte i hapur:

“Na duhen para për të mbrojtur të drejtat tona, për të fituar një Shqipëri të lirë dhe të madhe, për të organizuar Atdheun tonë, pas çlirimit. S’ka bisedim mbi këtë pikë!” Ky ishte urdhri i Atdheut.

Gjithçka ishte përcjellë në mënyrën urdhërore, pa vënë në dyshim realizimin. Komisioni arsyetonte:

“Çdo shqiptar i mirë e ka për detyrë të bëjë sakrificë për këtë qëllim të shenjtë për shpëtimin e Shqipërisë. As mbi këtë pikë s’ka bisedim!”

Pra, shqiptarët viheshin para faktit të kryer, pa patur nevojë për negociata e pa diskutime.

Komisioni arsyetonte se në Amerikë ishin në atë kohë rreth 50 mijë shqiptarë, por vetëm një pjesë e vogël e këtij numri ishte

e gatshme për sakrificë. Komisioni përllogariste rreth 3 mijë vetë të përfshirë në këtë aksion kombëtar, por parashikimi u tejkalua. Rreth 5 mijë vetë u bënë pjesë e fushatës, ku, natyrisht, prinë vatranët.

THIRRJA E KUVENDIT TË VATRËS

Kuvendi i Federatës “Vatra” i motit 1917, lëshoi këtë thirrje, para se të niste fushata e 3 qershorit:

“Shqipëria është e rrethuar prej armiqsh, që duan ta copëtojnë. Shpëtimin e saj e pret vetëm nga bijtë e saj fisnikë të Amerikës. Asnjë i huaj s’mund të na japë Lirinë dhe Independencën, të cilat duhet t’i fitojmë me duart tona, me djersën dhe gjakun tonë dhe me delegatët tanë të zgjedhur lirisht me zërin e popullit. Ndhini pra të gjithë, me sa të mundni! Mos dëgjoni fjalët e gabuara të njërit, apo tjetrit, por dëgjoni zërin e delegatëve tuaj të besuar, që dërguat në Kuvendin e Federatës tuaj të Madhe.”

“Vatra” informonte anëtarësinë:

“I pamë punët e delegatit tonë, z. Mehmed Bej Konitza; I gjetëm të mira me një zë dhe prapë me një zë vendosëm t’i japim dy shokë të tjerë, Dr. Turtullin dhe Nikoll Kasneci. Jemi të bindur, që këta delegatë do të bëjnë detyrën e tyre, po t’u japim “armë të mira” (dollarë) dhe sa t’u duhen. Ndhmoni pra pa u kursyer, që të shpëtojmë Shqipërinë nga mjerimet dhe ta trashëgojmë për veten tonë dhe për bijtë tanë dheun e lavdëruar të Skënderbeut.

Jepni qesen dhe shpirtin për Shqipërinë e lirë dhe të madhe! O burrani!”

Në fund firmosnin: Kryetari i Kuvendit - Hasan Bitincka, Sekretari - Ndreko Stavro, Komisioni: Kolë Tromara, Loni Kristo, Fan S. Noli, Xhevat Harxhi, Aqif Përmeti, Emin Bilibashi.

Më pas vinin emrat e delegatëve të Kuvendit: Bahri Omari, Kostaq Leçishti, Mina Grameno, Spiro K. Lubonja, Josif Pani, Ilias J. Përmeti, Stire Luka, Shefki Aliko, Mustafa S. Leshnja, D.J. Tushemishti, Foto Dukati, Koto Trebicka, Vangjel Spiro, Qani Bilishti, Duro Tabaku, Sadik Duro, Misto Papa, Vangjel Miller, Nico V. Grabocka, Marko Adams, Veli Harshova, Matto Tasi, George Luarasi, Angelo Sotir, Kolë Rodhe, Stathi Suli, Hajrulla Starja, Maliq Picari, Llambi Kreshpani, Andrea Kristo, Shefqet Frashëri, S. Blushi, Kostë Çekrezi, Adem Vishoshica, Faik Babani.

PERËNDIA ZGJODHI SHQIPTARËT E AMERIKËS
SI SHPËTIMTARË TË SHQIPËRISË

Kryetari i Vatrës Kolë Tromara dhe Sekretari Loni Kristo, para fushatës e nisnin mesazhin drejtuar shqiptarëve të Amerikës, botuar në Gazetën “Dielli” e “Vullnetari” dhe shtypin tjetër të shqiptarëve të Amerikës, me thënien e Dr. Turtullit në letrën drejtuar Vatrës: “Çlirimi dhe e ardhmja e Shqipërisë varen nga shqiptarët e Amerikës”.

Drejtuesit e Vatrës arsyetonin:

“Domethënë, ne vatranët dhe të gjithë shqiptarët e Amerikës, mund ta shpëtojmë Shqipërinë nga robëria dhe nga copëtimi dhe t’i japim Atdheut tonë lirinë e kufijtë e vet kombëtarë nga Veriu, Jugu, Lindja dhe nga Perëndimi. Ne mund ta madhojmë Shqipërinë e Konferencës së Londrës, duke fituar nga Konferenca e Paqes copërat e Atdheut, që na rrëmbyen fqinjët lakmonjës, duke marrë që tani masat, që ta mbrojmë nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.”

Kryetari Tromara dhe Sekretari Kristo, i prekën në shpirta shqiptarët e Amerikës, tek shkruanin:

“Perëndia na zgjodhi ne, Shqiptarët e Amerikës, si shpëtimtarë të Shqipërisë. Shqipëria jonë e pret shpëtimin dhe sigurimin e saj nga ne. S’ka shpresë nga ndonjë tjetër. Kështu na porositi Dr. Turtulli.”

Përse i duheshin Vatrës paratë e shqiptarëve të Amerikës, e sqaron mesazhi, përcjellë vatranëve dhe tërë shqiptarëve të Amerikës:

“Delegati i Vatrës, Mehmet Bej Konica dhe Dr. Mihal Turtulli, na e tregojnë se si ta shpëtojmë Shqipërinë. Duhet të dërgojmë delegatë nëpër Evropë, që të flasin e të mbrojnë Shqipërinë. Këta delegatë dhe të tjerë personalitete të zotë dhe miq të shqiptarëve, të shkojnë në Konferencën e Paqes dhe të kërkojnë me argumente një Shqipëri të lirë me kufijtë e saj etnografikë. Këta shqiptarë të zotë, më pastaj, të kthehen dhe të bëjnë Shqipërinë për shqiptarët. Për ta nisur këtë punë do të duhen së paku 40 mijë dollarë, na thotë Dr. Turtulli dhe ai vetë jep shembullin: ‘Duke na dërguar 1 000 dollarë, ndërkohë

që do të mjaftonte që shqiptarët e Amerikës të dhuronin secili nga 10 dollarë.’ Po ia nisim, - shkruajnë drejtuesit e Vatrës, - që sot, kështu e do nderi dhe detyra e shqiptarëve të Amerikës”.

Ata shtronin pyetjen: “Cili shqiptar i mirë, që i dhimbet Atdheu i mjeruar, nuk e do çlirimin, zgjerimin dhe sigurimin e Shqipërisë? Cili shqiptar i mirë, që i dhimbet shpirti për vëllezërit e robëruar, nuk do që ta kemi Kosovën, Toskërinë dhe Çamërinë?

Cili shqiptar i mirë nuk jep, jo vetëm qesen, po dhe shpirtin e tij për qëllimin e shenjtë? Ai që rri dhe diskuton këto pyetje, s’mund të jetë shqiptar i mirë dhe me këta s’kemi punë! E vetmja pyetje që do të bëjnë atdhetarët e mirë dhe fisnikë të Amerikës duhet të jetë: KUR? dhe SA?

Kur?

“3 qershor, në Ditën e Shpëtimit të Shqipërisë. Të gjithë bashkë, shoqërisht, si në kohë lufte me Flamurin përpara, një tok këtu, një tok atje, si taborë të një ushtrie që mblidhen, kur i thërret Trumbeta



Kolë Tromara



e detyrës.”

SA?

“Sa të mundni, më tepër se ç’ kení dhënë deri tani!...Aq sa do t’i jepnit mjekut për të shpëtuar nënën tuaj të sëmurë për vdekje. Të tërë qesen me shpirtin bashkë! Rrogën e një muaji, a rrogën e një jave, të paktën. Mos ia kurseni dhuratën Shqipërisë, se ia jepni vetes tuaj. Ç’i doni paratë, kur të na e rrëmbejnë vendin grekët dhe sllavët? Ç’e doni jetën jashtë Shqipërisë, të huaj në dhe të huaj, syrgjyn gjer në vdekje? Ç’e doni paranë dhe shtëpinë në Shqipërinë e robëruar pa liri, pa siguri, pa nder, me kokën ulur nën kërbacin e shkelësit të huaj në vendin tuaj?”

Këtë fushatë jetike e diktonte gjendja e Shqipërisë. Për drejtuesit e “Vatrës”, Shqipëria ishte e sëmurë, ishte në rrezik për vdekje, e shkelur, e djegur, e plagosur, e neveritur, pa ndihmës, e pa mbrojtës. Po e mban shpirtin ndër dhëmbë, me një fjalë e një shpresë: “Kam djemtë në Amerikë. Ata do t’ më shpëtojnë!” Ashtu, siç thoshte Korça, kur e dogji zjarri dhe e rrëzoi tërmeti. Ajo ngushëlloej se “kish djemtë kurbetli, në Misir e në Vllahi....”, që do ta ndërtonin dhe do ta bënin më të bukur...

Në thirrje shkruhej: “Na ka dalë namë, që kemi para’, që kemi shoqëria të mëdha këtu, në Amerikë, që s’flemë, veçse me një ëndërr; që s’flasim, veç për një dëshirë; që s’punojmë, veç për një qëllim, TA SHPËTOJMË SHQIPËRINË!”

Thirrja depërtonte në shpirta e zemra: “Dhe tani po na e këndojnë këngën jo vetëm fëmijët e vegjël, por edhe gurët, edhe drurët e ngushëllojnë dhe i japin gajret Nënës tonë Shqipëri në shtrat të zisë me këto fjalë:

“Mbahu, nëno, mos ki frikë

Se ke djemtë n’ Amerikë!”

A do ta lëmë të presë më kot e të mos i vemë kurrë? A do t’i dalim të pabesë Nënës sonë në orën e saj të ligë? A do të bëhemi të shurdhët për thirrjen e saj të fundme? Kurrën e kurrës!

Në qoftë se fati i saj varet nga ne, shqiptarët e Amerikës, Shqipëria do të çlirohet e do të trashëgohet. Në qoftë se mund ta ngjallim me paret tona, do të japim sa të mundim...”

Në thirrjen drejtuar shqiptarëve të Amerikës, përmendej shembulli i shkëlqyer i Dr. Mihal Turtullit, që dhuroi i pari dhe ftonte të tjerët.

Për aktin e tij shkruhej:

“Dyfeku i parë gjëmoi! Fisheku i parë vërsëlleu. Është një plumb prej 1 000 dollarësh. Ushitari, që e dha shenjën, është një nga ata djemtë e zgjedhur që ka Shqipëria në kurbet.

Nëna jonë e dëgjoi këtë shkrepje të parë dhe do të ketë thënë: “Vjen një djalë...! Po ata të tjerët, ku janë?... Pse s’dëgjohej?... Po ngrihet me mundim në shtrat, po vë veshin, po pret, duke numëruar minutat..... A po vijnë djemtë, të më shpëtojnë?!”

QPR

Qendra e Personel Rekrutimit do të rekrutojë kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Turqisë, 8 (tetë) të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 6 korrik 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:
<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/rekrutim-maj/20230529NJOFTIMU-D.pdf>



USHTAR / SUEL SHTALBI

BËHU VERSIONI YT MË I MIRË!

REGJISTROHU TE FORCAT E ARMATOSURA
PËR NJË KARRIERË UNIKE

REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TË SHQIPËRISË

**NE JEMI
NATO**

APLIKO NË QENDRËN
E REKRUTIMIT TË FORCAVE
TE ARMATOSURA.
SKANO QR CODE

Ti ke forcën që nderon kombin!
Bëhu edhe ti pjesë e Forcave të Armatosura të RSH
Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 25.09.2023 - 07.12.2023, gjithsej 439 kandidatë, (426 meshkuj dhe 13 femra), sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 04 shtator 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:
<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/rekrutim-maj/20230529NJOFTIMU-D.pdf>